

Koha

www.koha.mk



Një hap i madh për të ardhme të ndritshme

EDITORIAL

(Pa)plotnia e strategjisë kulturore



"Vera e Ohrit", "Mbrëmjet Poetike të Strugës", "Vera e Shkupi", "Vojdan Çernodrinski", "Skopje Jazz Festival", "Film Festival "Manaki", janë disa nga manifestimet kulturore që i financon shteti dhe disa prej tyre madje me dekada janë identifikuar si simbole të shtetësisë, siç është rasti me "Mbrëmjet Poetike të Strugës" apo "Vera e Ohrit". Është shumë normale që koncepti për kulturën të mos përjashtojë filozofinë e shtendërtimit...

DOSSIER

Pozita e shqiptarëve në RS të Maqedonisë

RAJON

Shqipëria dhe Kosova, të ndërtojnë BE-në brenda vetes



OBM DHE MINISTRIA E KULTURËS TË REZERVUAR

OPERA SKËNDERBEU E DESTINUAR TË DËSHTOJË?



Në Ministrinë e Kulturës nuk japin asnjë lloj komenti, jo vetëm lidhur me realizimin e projektit, por as me arsyet e pritjes për miratimin nga Ministria e Kulturës. Nuk japin përgjigje nëse pengesat me këtë projekt lidhen edhe me mangësi ligjore, apo me konceptimin dhe elaborimin e tij në përgjithësi

Zonat rurale, jashtë kujdesit primar

Shkup, 12 korrik - Ministria e Shëndetësisë, por edhe shumë politikanë (në platformat e tyre) zakonisht fokusohen në përmirësimin e cilësisë në shëndetësi, përmirësim të infrastrukturës, nivel më i lartë të pagave të punëtorëve dhe pajisje të reja nëpër spitale, duke u përqendruar vetëm në qytete. Por, në realitet në zona të caktuara rurale në territorin e Republikës së Maqedonisë, banorët nuk janë në mbrojtje

shëndetësore primare. Nuk kanë mundësi të ndjekin dhe bëjnë kontroll të gjendjes shëndetësore, këshillim për marrjen e masave parandaluese, çrënjosje dhe zbulim të hershëm të sëmundjeve dhe çrregullime të tjera të shëndetit. Në këto zona ndjehet edhe mungesa e dhënies së ndihmës emergjente shëndetësore, duke përfshirë këtu edhe automjetin sanitar që është më se i domosdoshëm...



EDITORIAL

(PA)PLOTNIA E STRATEGJISË KULTURORE



Emin AZEMI

“Vera e Ohrit”, “Mbrëmjet Poetike të Strugës”, “Vera e Shkupi”, “Vojdan Černodrinski”, “Skopje Jazz Festival”, “Film Festival “Manaki”, janë disa nga manifestimet kulturore që i financon shteti dhe disa prej tyre madje me dekada janë identifikuar si simbole të shtetësisë, siç është rasti me “Mbrëmjet Poetike të Strugës” apo “Vera e Ohrit”. Është shumë normale që koncepti për kulturën të mos përjashtojë filozofinë e shtendërtimit, por përkundrazi, të jenë komplementare me njëra tjetrën. Franca, bie fjala, njihet për shumë vlera e specifika, por janë Festivali i Kanës, Luvri, që i japin këtij shteti kuptimin esencial të identitetit shtetëror. Ngjashëm si Franca, janë edhe shumë shtete të tjera në botë që përmes brendeve kulturore kanë arritur të imponohen si trashëgues të vlerave që kultivohen me xhelozë dhe fanatizëm nga brezi në brez.

Edhe Maqedonia nuk bën përjashtim në përpjekjet e saja për të afirmuar ato vlera që konisiderohen si simbolikë e shtetësisë. Diplomacia kulturore bën punë plotësuese që nuk arrin ti bëjë politika e jashtme. Të gjitha manifestimet kulturore me karakter shtetëror janë edhe guida për të huajt dhe gjithë ata që vizitojnë Maqedoninë do ta njohin më mire Ohrin, bie fjala, nga festivali që mbahet në këtë qytet, ose Strugën përmes festivalit të poezisë.

Por, në Maqedoni ka edhe kultura të tjera. Ditë më pare përfundoi festivali tradicional “Këngë Jeho” që mbahet në Strugë dhe organizatorët u ankuan se këtë festival nuk e mbështet shteti. Është edhe një festival teatri në Dibër, për të cilin shteti nuk shpreh ndonjë interesim të posaçëm. Gjendja nuk është krejt zi, sepse ka ngjarje e krijime që financohen nga arka e shtetit, por gjithë mbështetja institucionale e kulturës së shqiptarëve nuk ndjek ndonjë strategji të mirëfilltë.

Kultura e festivaleve duhet dalluar nga kultura që prodhohet në vazhdimësi prej institucioneve. Në Shkup ka vite që funksionon një Qendër Teatrore për Fëmijë, mirëpo status i këtij institucioni ende është as në tokë as në qiell. Në komunat e banuara me shqiptarë ka qendra kulturore, por nuk ka teatro në gjuhën shqipe. Edhe ato pak asociacione të shkapërdhura krijuesish jo vetëm që nuk botojnë revista dhe botime të tjera, por nuk kanë të afishuar një plan-program vjetor, me të cilin do të identifikoheshin aktivitetet më të veçanta.

Kultura shqiptare, me disa përjashtime, assesi të ketë trajtim profesional. Koncentrimi i krejt vëmendjes në dy, tre institucione dhe anashkalimi i prodhimit që vjen nga terreni, nga qytetet e vendba-

nimet jometropolitane, edhe përforcon konstatimin se qasja amatore në kulturë e pamundëson atë të bëhet profesionale. Shpesh diskutohen këto tema në media, mirëpo drejtuesit institucional të kulturës nuk kanë treguar sens të mjaftueshëm që vërejtjet të evidentohen dhe të përpilohet një ministregji për kulturën shqiptare. Ideja e dikurshme për një departament a drejtori për kulturën shqiptare në kuadër të Ministrisë së Kulturës, duhet aktivizuar sërish. Objektivat e këtij dikasteri do të ishin në radhë të parë inventarizimi i nevojave dhe resurseve, pastaj operacionalizimi strategjisë kulturore përmes projekteve konkrete. Një kulturë kombëtare nuk mund të zhvillohet normalisht nëse nuk i ka fondet dhe resurset humane që do ta bënin atë të dinjitetshme në çdo aspekt. Por të gjitha këto nuk mund të arrihen nëse nuk hiqet dorë nga qasja e ngushtë partiake në mënyrë që me problematikën e ndjeshme kulturore të mos merren me çdo kusht aktivistët partiak. Njerëzit kompetent dhe profesional nga fusha të ndryshme mund të ofrojnë njohuritë e tyre teorike e praktike dhe për rrjedhojë Shkupi si kryeqytet të duhet të paktën të ketë një festival dinjitoz të muzikës, një festival të letërsisë dhe një të teatrit. Këto tre festivale duhet të kenë drejtoritë e tyre, buxhetet e tyre dhe kuadrot adekuatë që do të menaxhonin si linjat buxhetore, ashtu edhe aspektet organizative. Muzika, letërsia e teatri kanë një impakt të fuqishëm në publik, në kohën kur po ndodhin tendeca të çuditshme të akulturimit dhe zbehjes së vlerave fundamentale shpirtërore.

Prioritet e një shoqërie mund të jenë të shumta, mirëpo ato nuk mund të zëvendësohen me improvizime dhe amatorizma. Kultura shqiptare në Maqedoni duhet të ketë festivalet e veta, duhet të ketë revistat e veta, duhet të ketë godinat e veta. Tani si qëndrojnë punët, të gjitha aktivitetet kulturore të shqiptarëve kanë statusin e nënkontraktuesit dhe qiraxhiut. Prandaj duhet ndryshuar rrënjësisht praktikën e deritanishme të organizimit kulturor, në mënyrë që Maqedonia si shtet të mos prezantohet para botës si një shoqëri e vetme, pa specifika dhe diversitetin e saj kulturor. Në këtë drejtim një kontribut kolossal mund të japin edhe artistët e Shqipërisë e Kosovës të cilët mund t’i bartin përvojat e tyre në manifestimet që ende nuk po mbahen në Maqedoni.

Një strategji kulturore është e paplotë nëse nuk përfshin brenda vetës edhe dimensionet që e bëjnë më specifike atë, kurse diversiteti kulturor nuk duhet kuptuar vetëm si parullë, por edhe si platformë institucionale.

BISEDIMET PËR ANËTARËSIM NË NATO: NJË HAP I MADH DREJT NJË TË ARDHME MË TË NDRITSHME



Nga Jens STOLTENBERG

Këtë javë, vendi juaj është ftuar për të filluar bisedimet për praninë që të bëhet anëtar i 30-të i Aleancës së NATO-s. Ky është një hap i madh drejt një të ardhme të ndritshme dhe hapë derën për prosperitet dhe siguri më të madhe për ju dhe për më gjerë në Ballkanin Perëndimor.

Herë pas here, ju keni treguar guxim për të ndërtuar rrugën tuaj drejt paqes, sigurisë dhe pavarësisë, pavarësisht sa e vështirë ose sfiduese ka mund të jetë. Në vitin 2001, ju dhe udhëheqësit tuaj politikë dëshmuat se ka patur një alternativë për shabllonin e Ballkanit të luftës dhe shkatërrimit. Me mbështetjen e NATO-s dhe të komunitetit ndërkombëtar, duke përfshirë edhe përmes implementimit të Marrëveshjes së Ohrit, ju zgjidhët unitetin kombëtar kundrejt shkatërrimit kombëtar.

Që atëherë, ju keni punuar pa pushim për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe për të ndërtuar ura me fqinjët, duke përfshirë edhe Traktatin historik të Miqësisë me Bullgarinë. Marrëveshja historike me Greqinë për çështjen e emrit e ka hapur tashmë mundësinë e përparimit drejt integritetit transatlantik, duke përfshirë edhe anëtarësimin e plotë në NATO.

Anëtarësimi në NATO do t’i japë vendit tuaj një zë të barabartë në diskutimet tona, një votë të barabartë në vendimet tona dhe sigurinë që vjen nga të qenit pjesë e aleancës më të suksesshme ushtarake në botë. Kjo do të thotë që ka njëzetë vende të tjera të zotuar për t’ju mbrojtur ju dhe sovranitetin tuaj kombëtar kundër çdo agresori.

NATO është e angazhuar për ju dhe të ardhmen tuaj, dhe vendi juaj ka dëshmuar edhe vetë të jetë një mik i mirë i Aleancës. Ju ofroni mbështetje substanciale logjistike për ushtarët tanë në Kosovë. Dhe për shumë vite burra dhe gra trima e trimëresha të forcave tuaja të armatosura kanë ndihmuar për të sjellë paqe dhe siguri në Afganistan. Ju mund të jeni shumë krenarë me ata.

Anëtarësimi në NATO do të thotë gjithashtu mbështetje e mëtejshme për përpjekjet e juaja në reforma, në momentin kur të futeni brenda familjes Euroatlantike. Ju keni bërë progres të rëndësishëm në reformat kyçe, të tilla si reforma gjyqësore dhe mbikëqyrjen dhe llogaridhënien poli-

Udhëheqësit e NATO-s tani kanë ftuar vendin tuaj për të filluar bisedimet e anëtarësimit. Përderisa këto janë duke u zhvilluar, ju duhet të plotësoni procedurat tuaja kombëtare për të implementuar marrëveshjen e emrit. Pastaj, kur këto hapa janë të kompletuara, aleatët e NATO-s do të duhet të ratifikojnë praninë tuaj. Unë shpresoj shumë që shumë shpejt të shoh flamurin tuaj duke valëvitur në selinë e NATO-s si anëtare e 30 e Aleancës. Kjo është një mundësi një herë në jetë. E ardhmja juaj është në duart tuaja...

tike të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë. Ka ende punë për të bërë, duke përfshirë reformën zgjedhore, lirinë e mediave, si dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. NATO do të jetë me ju në çdo hap të rrugës. Për shembull, me mbështetje praktike për reformat e mbrojtjes, për të ndihmuar në përmirësimin e arsimit në mbrojtje dhe investime, si dhe për rritjen e transparencës në sektorin e mbrojtjes.

NATO është thellësisht e lidhur me vendet e rajonit tuaj dhe stabilitetin e tij të vazhdueshëm. Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Mali i Zi dhe Sllovenia i janë bashkuar NATO-s, Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina janë partnerë të ngushtë dhe me vlerë, dhe forcat tona të NATO-s në Kosovë vazhdojnë të ruajnë paqen dhe stabilitetin.

Udhëheqësit e NATO-s tani kanë ftuar vendin tuaj për të filluar bisedimet e anëtarësimit. Përderisa këto janë duke u zhvilluar, ju duhet të plotësoni procedurat tuaja kombëtare për të implementuar marrëveshjen e emrit. Pastaj, kur këto hapa janë të kompletuara, aleatët e NATO-s do të duhet të ratifikojnë praninë tuaj. Unë shpresoj shumë që shumë shpejt të shoh flamurin tuaj duke valëvitur në selinë e NATO-s si anëtare e 30 e Aleancës.

Kjo është një mundësi një herë në jetë. E ardhmja juaj është në duart tuaja.

(Autori është sekretar i përgjithshëm i NATO-s. Nga mediat shqipe, gazeta KOHA mban të drejtën ekskluzive për botimin e këtij shkrimi)

ZAEVI PARALAJMËRON FESTË NË 15 QYTETE TË MAQEDONISË

FESTË NËN ETHET E REFERENDUMIT

Përfaqësues kryesor i NATO-s do të jetë James Mackey nga departamenti i çështjeve politike dhe të sigurisë pranë kësaj organizate, ndërkohë që bisedimet para-aderuese tashmë mund të konsiderohen të nisura që nga momenti i marrjes së ftesës për anëtarësim. Tani i mbetet Maqedonisë që ta përgatisë ekipin e saj për bisedimet para-aderuese me NATO-n, i cili duhet të jetë i përbërë nga përfaqësues të ministrive të ndryshme dhe institucioneve të tjera



anëtarësim. Tani i mbetet Maqedonisë që ta përgatisë ekipin e saj për bisedimet para-aderuese me NATO-n, i cili duhet të jetë i përbërë nga përfaqësues të ministrive të ndryshme dhe institucioneve të tjera. Bisedimet para-aderuese pritet të përfundojnë më së voni deri në mars të vitit 2019, ndërsa deri atëherë - Maqedonia do të duhet ta finalizojë Marrëveshjen me Greqinë për emrin, me qëllim që vendet anëtare të NATO-s të nisin ratifikimin e protokollit aderues. Procesi i tërësishëm i anëtarësimit pritet të përfundojë brenda 1 viti e gjysmë. Siç ka njoftuar koordinatori nacional për në NATO, Stevo Pendarovski, pas marrjes së ftesës, javën e ardhshme Qeveria duhet të marrë planin për në NATO, sipas të cilit, saktë duhet të udhëhiqemi në përfundimin e reformave ushtarake-teknike dhe ky plan është identik për çdo vend aspirant.

"Ajo që është specifike për Maqedoninë dhe që është detyrë e jonë konkrete e shtëpisë që ta implementojmë deri në fund marrëveshjen me Greqinë - Marrëveshjen e Prespës, dhe NATO-ja do të na vlerësojë nëpër këtë prizëm. Do të thotë, nuk do të jetë të mjaftueshme vetëm këto kushte juridike teknike ushtarake, por edhe politike dhe legale t'i plotësojmë në katër deri në gjashtë muajt e ardhshëm nga ky rast, por do të nevojitet ta përfundojmë edhe procedurën për ratifikimin për referendum lidhur me marrëveshjen dhe kuptohet ndryshimet kushtetuese", tha Pendarovski.

KACIN FTON QYTETARËT TË KUPTOJNË MOMENTIN HISTORIK

Ndërkaq ka vijuar përkrahja e vendeve mike për Maqedoninë siç ishte rasti me qëndrimin e ambasadorit të Sllovenisë në NATO, Jellko Kacin. Ai porositi nga Brukseli se nga qytetarët e Maqedonisë va-

KONFIRMUOHET PIKAT KRYESORE TË FTESËS PËR NË NATO

Liderët e shteteve të NATO-s kanë miratuar komunikatën e përbashkët të Samitit të Aleancës në Bruksel me këto pika kryesore: Konfirmohet klauzola për mbrojtje të Tokës; Shpenzimet për mbrojtjen; Çështja Rusia; Çështja Ukraina; Terrorizmi; Universi; Struktura e përmirësuar komanduese; si dhe Misioni në Irak.

ret nëse vendi do të bëhet anëtare e Aleancës. "Vendimi në Greqi veçmë është miratuar, kushtet janë në anën e juaj, pasi të përmbushen kushtet presim sinjal pozitiv nga Athina. Të mos merrim porosi pozitive sekretari gjeneral sot nuk do të mund të nënshkruante dokumentin dhe të fillojnë negociatat inkuadruese", ka thënë Kacin. Siç tha ai, pas dorëzimit të ftesës kryeministrit Zoran Zaev, do të fillojnë negociatat inkuadruese me vendet anëtare dhe ratifikimin nga ana e tyre, pasi në referendum të kalojnë ndryshimet kushtetuese të parapara me marrëveshjen me Greqinë. "Pa këto ndryshime kushtetuese, Maqedonia nuk mund të bëhet anëtare, por ftesa nuk mund të tërhiqet. Jemi të vendosur t'i ofrojmë shansin Maqedonisë dhe do të bëjmë gjithçka që është në mundësitë tona, pra të ndihmojmë qytetarët të kuptojnë momentin historik pas gjithë atyre viteve bllokadë. E Maqedonisë është të vendos nëse pranon kompromis dhe të plotësojë Kushtetutën e saj që në fillim të vitit të ardhshëm ministrat e juaj të mund të jenë me ne në mbledhjet e NATO-s", ka thënë Jellko Kacin.

PËR VMRO-NË, FTESA ISHTE E KUSHTËZUAR

Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickoski, ka dalë me reagim pas marrjes së ftesës për hyrjen e Maqedonisë në NATO. Sipas Mickoskit nuk as datë për negociatat me BE-në, as edhe ftesë të

pakushtëzuar për në NATO dhe se partia e tij do të vazhdojë të luftojë me forcat e saja vetanake kundër siç thotë, "kësaj të keqe që e përjeton çdo qytetar". "Për pushtetin fjala nuk është fjalë, as edhe veprat realitet. Patjetër të ndalojnë disfatat, ndërsa përgjigjja për këtë është secili prej jush. Erdhën në pushtet me premtimin për jetë më të mirë dhe paga më të larta. Premtuan mrekulli. Ndërsa, tani kur janë në pushtet heshtin për padrejtësitë, vrasjet e gjakftohta i trajtojnë si evidencë statistikore, për qeverinë ato janë dhunë e zakonshme dhe jo vrasje mizore", ka thënë Mickoski duke shtuar se partia e tij do të vazhdojë të protestojë duke bërë njëherësh thirrje për marsh protestues këtë të diel në ora 13 në Kavadar. "Maqedonia do të fitojë, Maqedonia po zgjohet. Ju presim, bashkangjituni me ne", ka nënvizuar Mickoski. Mendim të njëjtë për ftesë të kushtëzuar në NATO ka dhënë edhe partia "E majta". Në ditën kur po mbahet Samiti i NATO-s në Bruksel (11 dhe 12 korrik), diplomacia maqedonase në vend të ftesës së qartë dhe të pakontestueshme - mori vetëm se "duartrokitje" dhe kushtëzimin që vitin e ardhshëm të trokas përsëri në dyert e NATO-s si diplomaci maqedonaso-veriore, kështu vlerëson Paria e "Majta". "Kjo nuk është dështim vetëm se për Planin "3-6-9", por edhe dështim për popullin i cili përsëri mbeti i gënjyer nga LSDM-ja. Në vend që Qeveria të merret me problemet, ajo po fut popullin

në mizerje sociale", thonë nga kjo parti.

ÇKA DUHET TË NDOHË DERI TE ANËTARËSIMI I PLOTË NË NATO

Pas marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO, Maqedonisë i është qartësuar rruga përmes të cilët duhet të ecë për t'u bërë anëtare e 30 e aleancës veri-atlantike. Fillimisht, ashtu siç parashikon edhe Marrëveshja e Prespës, Maqedonia duhet të shkojë në referendum. E drejtë e qytetarëve kjo e cila aktualisht është në qorr-sokak për shkak të mungesës së KSHZ-së dhe bllokimit të procedurës në Kuvend. Varësisht rezultateve të referendumit, do të hapet çështja e ndryshimeve Kushtetuese, ku Maqedonia do të duhet të ndërhyjë në disa çështje, si preambula, largimi i termit qytetar të Maqedonisë, largimin e çdo lloj pretendimi për irredentizmi ose aspiratash ndaj Greqisë dhe historisë antike. Kjo parashikohet të jetë pjesë më e vështirë për faktin që për hapjen e Kushtetutës dhe ndryshimet në të nevojiten 2/3 e votave në Kuvend. Nga ana tjetër, nuk përjashtohet mundësia që opozita të parashtrijë numër të madh të amendamenteve. Paralajmërimet për amendamente i kanë shfaqur edhe partitë opozitare shqiptare të cilat, jo zyrtarisht, do të tentojnë që përpos largimit të përcaktimit 20% të saktësojnë edhe çështjen e identitetit të qytetarëve shqiptar në dokumentet zyrtare. Në rast se Qeveria dhe opozita kalojnë me sukses ndryshimet Kushtetuese, pason faza e krijimit të Komisioneve të përziera, ku duhet përfshihen ekspertë të fushave të cilët do të negociojnë me komisionet e aleancës veri-atlantike. Pas përfundimit të negociatave dhe dy sesioneve të parapara, procesi i anëtarësimit nis drejtë parlamenteve të vendeve anëtare të NATO-s. Marrëveshja duhet ratifikuar në 29 shtete anëtare dhe në Kuvendin e Maqedonisë. Vlen të theksohet fakti që në disa parlamente dhe në senatin amerikan, ratifikimi duhet votuar me 2/3 e votave. Pas kësaj faze, kryeministri Zaev deponon marrëveshjen dhe rezymenë e fazave të realizuara në Departamentin amerikan të shtetit. Kur të konstatohet se Maqedonia ka plotësuar kushtet e parapara, NATO zyrtarisht ngrit flamurin shtetëror të vendit në shtizën e 30 ndërsa ulësja e Maqedonisë Veriore në këtë rast do të jetë pranë Norvegjisë. Në Aleancë vendi jonë do të njihet si "North Macedonia" (Maqedonia e Veriut). Pas zyrtarizimit të anëtarësimit, pason faza e përfshirjes në komisionet ndër-nacionale në kuadër të NATO-s.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 12 korrik - Pas marrjes së ftesës për aderim në NATO, kryeministri Zaev tha të enjten nga Brukseli se të shtunën do të festohet në 15 qytete të Maqedonisë, më gjasë për të nisur në atmosferë festive fushatën pro-referendumit. Po për referendumin Zev tha se sapo të kthehet në Shkup, menjëherë do të fillojë konsultimet me partitë parlamentare për të kohen dhe mënyrën e mbajtjes së tij. "Nga sot Maqedonia shkon vetëm përpara, ndërsa qytetarët kanë edhe një sukses të madh. Urime Maqedoni. NATO vendosi të na dërgojë ftesë për t'u bërë anëtarja e 30-të e Aleancës. Morëm ftesën për t'u bërë aleat i vendeve më të fuqishme anëtare në botë. Kjo është ftesë për anëtarësim të plotë në aleancën udhëheqëse për paqe dhe siguri në skenën ndërkombëtare", deklaroi kryeministri Zaev. Ai tha se "pamë edhe një ditë tjetër të madhe, duke i arritur qëllimet tona të përbashkëta strategjike, shpresat dhe ëndrrat tona të përbashkëta".

JAVËN E ARDHSHE NISIN NEGOCIATAT PARAADERUESE

Sa i përket nisjes së bisedimeve para-aderuese, merret vesh se përfaqësues kryesor i NATO-s do të jetë James Mackey nga departamenti i çështjeve politike dhe të sigurisë pranë kësaj organizate. Megjithatë një burim i lartë i NATO-s thekson se bisedimet para-aderuese tashmë mund të konsiderohen si të nisura që nga momenti i marrjes së ftesës për

Paraburgim për pedofilin 70-vjeçar nga Prilepi

Shkup, 12 korrik - Paraburgim prej 30 ditëve i është caktuar 70-vjeçarit nga Prilepi, i cili ka kryer ngacmim seksual mbi një vajzë pesëvjeçare. Në buletin e sotëm të policisë theksohet se kundër 70-vjeçarit S.Ç. është ngritur kallëzim penal për shkak të dyshimit për vepër të kryer penale "ngacmim seksual mbi një fëmijë që ende nuk ka mbushur 14 vjet". Rastin në polici e ka denoncuar 23-vjeçarja nëna e vajzës. I moshuari e ka kryer veprimet seksuale mbi vajzën derisa ajo ka luajtur në rrugën "Nikolla Karev" në Prilep.

Për herë të parë në Maqedoni transplatohet zemër tërësisht artificiale

Shkup, 12 korrik - Një burri 46 vjeçar nga Shtipi me dobësi të jashtëzakonshme në zemër sot i është transplatuat zemër tërësisht artificiale në Spitalin klinik "Axihiadem Sistina" në Shkup. Pacienti në gjendje stabile shëndetësore ndihet mirë, informojnë nga Klinika. Bëhet fjalë për një ndërhyrje të parë të tillë kirurgjike në Maqedoni. Operacioni ka zgjatuar më shumë se pesë orë e gjysmë, ndërsa e ka kryer ekipi i Klinikës, i kryesuar nga shefi i Sektorit për kardiokirurgji, prof.dr. Aleksandar Nikoliq. Zemra mekanike është me madhësi të njëjtë si ajo paraprake. Mbushet me bateri, të cilën pas daljes nga spitali, pacienti do ta mbajë në një çantë speciale në shpinë, me peshë prej gjashtë kilogramëve. Vendosja e zemrës mekanike është një trend në kardiokirurgjinë botërore, duke e pasur parasysh faktin që gjithnjë e më vështirë arrihet deri tek zemra që dhurohet, theksojnë nga Klinika. Në korniza botërore janë kryer 1.800 operacione të tilla, ndërsa Maqedonia ka hyrë në listën e 25 vendeve në botë ku kryhet ky intervenim i vështirë dhe më i ndërlikuar në kardiokirurgji, përveç shteteve siç janë SHBA-ja, Kanada, Franca, Gjermania, Turqia, Britania e Madhe, Italia.

Memorandum për mirëkuptim me 18 anëtare të NATO-s

Shkup, 12 korrik - Ministria e Mbrojtjes, Radmila Shekerinska dje në selinë e NATO-s në Bruksel, nënshkroi Memorandum për mirëkuptim me të cilin Maqedonia i bashkëngjitet iniciativës "Smart Difens" për municion për luftë tokësore. Siç kumtoi Ministria e Mbrojtjes, Memorandumin e mirëkuptimit ministria Shekerinska e nënshkroi me 17 ministra të mbrojtjes nga vendet-anëtare të NATO-s, dhe me kolegun e saj nga Finlanda, partnere e NATO-s. Përveç Belgjikës, si udhëheqëse e kësaj iniciative, midis nënshkruesve të Memorandumit janë Gjermania, Franca, Danimarka, Spanja, Norvegjia, Austria, dhe nga rajoni - Sllovenia dhe Mali i Zi. Memorandumin për mirëkuptim vendos kornizë e cila siguron grupimin

OBM DHE MINISTRIA E KULTURËS TË REZERVUAR

OPERA SKËNDERBEU

E DESTINUAR TË DËSHTOJË?


Në Ministrinë e Kulturës nuk japin asnjë lloj koment, jo vetëm lidhur me realizimin e projektit, por as me arsyet e pritjes për miratimin nga Ministria e Kulturës. Nuk japin përgjigje nëse pengesat me këtë projekt lidhen edhe me mangësi ligjore, apo me konceptimin dhe elaborimin e tij në përgjithësi

Koha

Evis HALILI

Shkup, 12 korrik - Realizimi i një prej projekteve më të rëndësishme për kulturën shqiptare të këtij viti, opera "Skënderbeu", është vënë në pikëpyetje. I prezantuar si pjesë e Programit Vjetor të Ministrisë së Kulturës dhe i Operës dhe Baletit të Maqedonisë, projekti duhet të ngjitet në skenë në muajin nëntor (më 22 ose 28 nëntor), si pjesë e manifestimeve mbarëshqiptare me rastin e Vitit të Gjergjit. Si në Operën dhe Baletin e Maqedonisë, ashtu edhe në Ministrinë e Kulturës janë të rezervuar të japin komente për këtë projekt, dosja e të cilit po endet prej disa muajsh brenda institucionit dhe për rrjedhojë - askush nuk e merr përsipër që të merret me këtë çështje që duhej të ishte mbyllur me shpalljen e rezultateve të Programit Vjetor.

Nga Opera dhe Baleti janë në pritje të miratimit nga ana e Ministrisë së Kulturës për të filluar me këtë projekt. Drejtori i këtij institucioni, Qazim Asotiq, pohon se nuk mund të japë asnjë informacion për aq kohë sa është në pritje të konfirmimit. Sipas Asotiq, OBM ka konkurruar me "Skënderbeun" në konkursin për Programin vjetor me interes nacional, ndërkohë që projekti nuk figuron në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës ku janë shpallur projektet e miratuara për Operën dhe Baleti. Në Programin vjetor të Operës figurojnë realizimi i vetëm dy premierave gjatë këtij viti - "Bohemët" dhe "Karmen".



"Nuk mund të jap asnjë informacion, pasi presim që Ministria të japë pëlqimin. Nuk besoj se ka probleme, por ndërrimi i ministrave dhe ato proceset e dorëzimit-marrjes së postit, marrin kohë", thotë Asotiq. Drejtori nuk jep shpjegime as për koston financiare të projektit të propozuar prej tyre, që sipas deklarimeve të disa muajve më parë, nga Ministria e Kulturës opera do të ketë një kosto prej tre milionë denarë.

Katër muajt e mbetur në dispozicion nuk dihet nëse do të jenë të mjaftueshme për të realizuar një projekt të prezantuar nga zyrtarët shqiptarë të Ministrisë së Kulturës si grandioz. Opera me dy akte e kompozuar nga Fatos Lumani, libret që do të bazohet tek poema me të njëjtin titull të Naim Frashërit, është ideuar që të përfshijë një numër të madh instrumentistësh, këngëtarë, kor, skenografi, e të tjera. Në Ministrinë e Kulturës nuk japin asnjë lloj koment, jo vetëm lidhur me realizimin e projektit, por as me arsyet e pritjes për miratimin nga Ministria e Kulturës. Nga Ministria e Kulturës nuk japin përgjigje nëse pengesat me këtë projekt lidhen me mangësi ligjore, apo me konceptimin dhe elaborimin e tij në përgjithësi.

QAZIM ASOTIQ

Nuk mund të jap asnjë informacion, pasi presim që Ministria të japë pëlqimin. Nuk besoj se ka probleme, por ndërrimi i ministrave dhe ato proceset e dorëzimit-marrjes së postit, marrin kohë

Kjo do të ishte opera e parë e kompozuar nga një kompozitor nga Maqedonia dhe e dyta nga një autor shqiptar me tematikë nga jeta e heroit kombëtar. Preng Jakova në vitin 1966 kompozoi operën "Skënderbeu", me libret nga Llazari Siliqi që bazohej tek vepra e Marin Barletit. Kjo operë u shfaq gjashtë vjet më parë në Shkup me rastin e shënimit të 100 vjetorit të Pavarësisë. Ndërkohë që në botë njihen edhe dy opera të tjera kushtuar heroit shqiptar, të kompozuar në shekullin e XVIII-të, në Itali dhe Francë. E para është realizuar nga kompozitori Antonio Vivaldi dhe libretisti Antonia Salvi, ndërsa e dyta "Skënderbeg- Tragjeditë" nga Rebeck dhe Frankër dhe libret të Mote.

KSHZ të mos kushtëzohet me ligje të tjera

Shkup, 12 korrik - Përzgjedhja e përbërjes së re të KSHZ-së nuk duhet të varet nga kurrfarë pako të tjera dhe ligjesh të tjera, sepse formimi jo në kohë i Komisionit mund të shkaktojë probleme në organizimin e referendumit.

"Unë nuk jam pjesë e procesit negociator dhe nuk mund të pohoj realisht cili është kushti i opozitës, por përzgjedhja e KSHZ-së nuk guxon të vendoset në pako me kurrfarë amnisti, me kurrfarë kushte për qeveri teknike, të Përzhinës ose çfarëdo qeverie, sepse neve na duhen institucione të cilat funksionojnë veçanërisht në parajmërimin e referendumit të ardhshëm", tha ministria Deskoska, duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve para mbajtjes së tryezës së sotme të rrumbullakët në temë "Përmirësimi i modelit të financimit të



partive politike në Maqedoni". Çdo vonesë me formimin e Komisionit, shtoi, mund të thotë edhe gatishmëri e pamjaftueshme që anëtarët e sapozgjedhur t'i zbatojnë të gjitha aktivitetet që janë të nevojshme.

Luftimi kundër trafikimit me lëndë narkotike ka qenë prioritet i policisë së shtetit për vitin 2017. Në Raportin e Byrosë për Siguri Publike për vitin e kaluar thuhet se janë ndërmarrë një sërë masash për zbardhjen e vrasjeve, luftimit e krimit të organizuar dhe luftën kundër korrupsionit

RAPORT VJETOR I BSP-së

12 GRUPE KRIMINELE MË PAK!



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 12 korrik - Policia e shtetit gjatë vitit 2017 ka arritur rezultate të shkëlqyeshme në luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike. Kështu së paku thuhet në Raportin vjetor të Byrosë për Siguri Publike, i cili u publikua së fundmi (viteve të kaluara zakonisht është publikuar në muajt mars apo prill) e ku thuhet se zbulimi i laboratorit të drogës në Tetovë, vlera e të cilit arrinte 2.5 milionë euro, paraqet suksesin më të madh të BSP-së. Lufta kundër krimit të organizuar, siç thonë nga BSP, ka qenë prioritet i saj për vitin 2017. Përmes aksioneve të ndryshme, policia e shtetit vitin e kaluar në mënyrë sistematike i ka shkatërruar 12 grupe kriminele, me çka janë denoncuar 116 persona fizik dhe dy persona juridik.

"Mbi 90 për qind e të denoncuarve janë shtetas të Maqedonisë, gjegjësisht pjesë e këtyre grupeve kriminele kanë qenë edhe 12 shtetas të huaj. Sektori për shkatërrimin e krimit të organizuar ka meritën më të madhe për luftën kundër grupeve të theksuara. Pjesa dërmuese e grupeve (shtatë prej tyre) janë marrë me trafikim të lëndëve narkotike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar e kështu me radhë", thuhet në raportin e BSP-së.

Krimi i organizuar ekonomik po ashtu ka zënë vend në hetimet dhe lëndët e trajtuara nga BSP. Kësisoj, siç njoftojnë nga Mi-

nistria e Punëve të Brendshme, pjesë krimit të organizuar ekonomik, gjatë 2017 kanë qenë mbi 1000 persona, të cilët kanë shkaktuar dëm material në vlerë prej 2.7 milionë denarë ose 65 për qind të dëmit nga krimi i përgjithshëm.

"Në këto veprime të jashtëligjshme kanë marrë pjesë 54 anëtarë, mes të cilëve kryetar komunash, udhëheqës sektorësh në ministri të ndryshme, të punësuar në policinë e shtetit, gjykatës, pronarë kompanish, anëtarë këshilla e kështu me radhë. Të gjithë këto, sipas të dhënave zyrtare, e kanë dëmtuar buxhetin e shtetit për gati 370 milionë denarë", theksohet në raportin e BSP-së.

Ndryshimi i rutës së emigrantëve nga Lindja e Mesme dhe Afrika përmes territorit të Shqipërisë ka ndikuar që në Maqedoni, gjatë vitit 2017, të shënohet rënie e trafikimit me emi-

grantë. Megjithatë, të dhënat e publikuara nga BSP thonë se nga janari deri në dhjetor të vitit të kaluar janë zbuluar 212 emigrantë në tentimet e tyre për t'u futur ilegalisht në Maqedoni. Meqë të njëjtit janë ndihmuar nga trafikantë, organet e rendit kanë ndërmarrë masa kundër 36 personave. Analizat e kryera mbi identitetin e trafikantëve, kanë zbuluar se mbi 88 për qind e tyre vijnë nga Shkupi me rrethinë, gjegjësisht një numër i vogël i trafikantëve që i ndihmojnë (me pagesë) emigrantët të futen ilegalisht në vendin tonë janë nga Gjevgjelia apo Velesi.

Për shkak të karakterit të delikteve me elemente të dhunës, MPB vitin e kaluar maksimalisht ka qenë e përkushtuar dhe e angazhuar në zbardhjen e vrasjeve, vjedhjeve, kërcënimeve dhe delikteve seksuale. Sipas tyre, në territorin e Maqedonisë, gjatë

2017 janë regjistruar gjithsej 25 vepra penale "vrasje", për të cilën janë arrestuar 29 persona. Këto shifra paraqesin rritje të këtij lloji të krimit për rreth 50 për qind më tepër.

"Pas masave të ndërmarrura janë zbardhur dhe dokumentuar 21 vrasje, kurse të pazbuluara kanë mbetur katër vrasje - dy në Shkup, në rajonin e Çairit, vrasja e një 35 dhe 25 vjeçari, pastaj vrasja e një banori të Veleshtës në rrethinën Strugës dhe një vrasje në Prilep. Duke e hulumtuar mënyrën e kryerjes së vrasjeve, kemi konstatuar se 12 vrasje janë realizuar me armë zjarri, 6 tjera përmes mjeteve të forta, gjegjësisht 5 vrasje janë kryer me përdorimin e thikave dhe një tjetër me përdorimin e forcës dhe derivateve djegëse. Viktima të këtyre veprave panele kryesisht janë meshkuj, duke përfshirë edhe tetë gra", thuhet në raportin e BSP-së.

KRONIKË

Paditet shkupjani që vidhte çantat e të punësuarve

Kallëzim penal është ngritur kundër një shkupjani 39-vjeçar i cili i ka kryer katër grabitje në firma në Shkup dhe më pas ka përfutur dobi pronësore të paligjshme prej rreth 62 mijë denarësh. Gjykatësi me procedurë paraprake i caktoi masë arresti në kohëzgjatje prej tetë ditësh. Policia sot kumtoi se i dyshuari B.D. vjedhjet i ka bërë në periudhën prej më 30 prill deri më datën 6 të këtij muaji në katër firma prej të cilave njëra në rajonin qendror të qytetit dhe tre në lagjen Çair. Vjedhjet i ka kryer në mënyrë që ka hyrë në firmat dhe pasi do të bindej se në zyra nuk është askush, është afruar pranë byrosë së punës në të cilat kanë qëndruar çantat e të dëmtuarve. Në tre raste ka marrë portofolë, ndërsa në një rast e ka hapur byronë e punës prej ku i ka marrë paratë prej qarkullimit ditor dhe pa u vërejtur nga askush e ka braktisur vendin e ngjarjes. Në bisedën informative ai në tërësi i ka pranuar dhe përshkruar mënyrën e kryerjes së veprave penale.

Gjashtë persona rrahin dy të rinj tetovarë

30 vjeçari me iniciale L.K dhe 24 vjeçari që të dy nga Tetova të mërkurën mbrëma kanë denoncuar se rreth orës 23, me veturë "Citroen" kanë lëvizur në rrugën "JNA" në Tetovë dhe në një moment i kanë ndaluar të kalojnë gjashtë persona të panjohur. Pas një zënke të shkurtër me ata, të dy të rinjtë tetovarë janë sulmuar fizikisht me grushta dhe shqelma, ndërsa personi L.K ka marrë lëndime të rënda në kokë dhe i është dhënë ndihmë mjekësore në Spitalin Klinik të Tetovës. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Konfiskohet armatim në Bërvenicë

Të mërkurën në fshatin Bërvenicë, me urdhër të Gjykatësit Hetues në procedurë paraprake, pjesëtarë të SPB-së në Tetovë kanë kryer kontroll në një shtëpi pronë e G.J.S. 52 vjeçar, me ç'rast janë gjetur një pistoletë e tipit "Zbroevka", me kalibër 7.65 milimetër dhe një arkë të madhe me municion ku ka patur pesë minahedhës dhe dy bomba dore. Është njoftuar prokurori publik dhe pas përfundimit të kontrollit, personi në fjalë është arrestuar. (U.H)

Mbi 7 vite burg për gjyshin e Tamarës



Shkup, 12 korrik - Lupço Stojanovski, gjyshi i vogëlushes së ndjerë Tamara Dimovska nga Velesi, është dënua me shtatë vite e gjysmë burg për veprë penale "tentim vrasje" ndaj

ish-ministrit të Shëndetësisë, Nikolla Todorov. Në arsyetimin e aktgjyqimit, gjykatësja Sofija Laliçiq tha se nga prezantimi i dëshmitëve është vërtetuar qëllimi i qartë i të pandehurit Stojanovski, se gjatë shtënies me armë ka dashur ta vret të dëmtuarin Todorov. Prokurori njëherësh kërkoi vazhdim të masës së paraburgimit derisa vendimi gjyqësor nuk bëhet i plotfuqishëm, respektivisht pala mbrojtëse kërkoi lirimin e klientit të tyre. Mbrojtja e Stojanovskit gjatë fjalimit të tyre theksoi se Prokuroria e Shkupit, gjatë prezantimit të dëshmitëve, nuk ka parashtruar prova të forta dhe të qëndrueshme që e vërte-

tojnë qëllimin e klientit të tyre. Stojanovski, përmes avokatëve të tij brenda dy jave ka mundësi ta ankimojë vendimin e Gjykatës Penale të Shkupit pranë Gjykatës së Apelit. Ndryshe, rasti në fjalë u regjistruar në qershor të vitit të kaluar, në kohën kur ish ministri Todorov e dorëzonte detyrën e tij. Stojanovski e kishte konsideruar ish-ministrin Todorov fajtor për vdekjen e mbesës së tij, të cilën si Komisioni i Fondit të Shëndetësisë ashtu sikurse Komisioni i Ministrisë së Shëndetësisë, i kishin vonuar procedurat për trajtimin jashtë shtetit të Tamarës së vogël. (O.Xh)

SUBVENCIONIMI I PAGËS MINIMALE

PAGUANI PUNËTORËT OSE NUK I GJENI

Nga Organizata e Punëdhënësve presin që një pjesë e konsiderueshme e kompanive të shfrytëzojnë mbështetjen qeveritare, sepse në të kundërtën - siç thotë Angel Dimitrov, rrezikojnë ndërprerjen e procesit të punës në ndërmarrjet e tyre



ANGEL DIMITROV

Gjysma e punëdhënësve e ballafaquar me mungesën e madhe të punëtorëve në tregun e punës pritet që edhe të rritin pagën minimale. Mund të pritet bile që në vend rritjes së planifikuar prej 5 për qind me ndihmën shtetërore, pagat të rriten edhe deri në 10 për qind si rrjedhojë e ikjes së madhe së punëtorëve jashtë shtetit

Koha / Fisnik PASHOLLI

Shkup, 12 korrik - Kompanitë që në të ardhmen do të rrisin pagën minimale nga 12 në 15 mijë denarë do të fitojnë afër 1000 denarë ndihmë shtetërore. Vendimi qeveritar për subvencionimin e rritjes së pagave së një pjese të punëdhënësve, përmes përkrahjes direkte financiare prej 30 për qind për rritjen e bruto pagave, së shpejti pritet të marrë dritën e gjelbër nga të zgjedhurit e popullit.

Me ndryshimet ligjore që me procedurë të shpejtë para një jave kaluan filtrat qeveritar, parashikohet që nëse punëtori ka pagën prej 12 mijë denarë, ndërsa punëdhënësi ia rrit pagën për 3000 denarë më shumë, atëherë 30 për qind e kësaj shume do të subvencionohet nga ana e shtetit. Këtë masë mund ta shfrytëzojnë të gjitha bizneset private, tek të cilat harxhimet për paga janë më të

mëdha se 50 për qind e totalit të harxhimeve. Nga Organizatat e Punëdhënësve presin që një pjesë e konsiderueshme e kompanive, ku vetëm vitin e kaluar mbi 90 mijë punëtorë kanë marrë pagë prej afër 200 euro, ta shfrytëzojnë këtë mbështetje qeveritare. Në të kundërtën, rrezikojnë ndërprerjen e procesit të punës në ndërmarrjet e tyre, vlerësojnë përfaqësuesit e punëdhënësve.

"Gjysma e punëdhënësve e ballafaquar me mungesën e madhe të punëtorëve në tregun e punës pritet që edhe të rritin pagën minimale. Mund të pritet bile që në vend rritjes së planifikuar prej 5 për qind me ndihmën shtetërore, pagat të rriten edhe deri në 10 për qind si rrjedhojë e ikjes së madhe së punëtorëve jashtë shtetit", thotë Angel Dimitrov, kryetar i Organizatës së Punëdhënësve të Maqedonisë.

Në favor të rritjes së pagave në shtet, qoftë edhe me subvencione,

flet edhe fakti se në tregun e punës në Maqedoni figurojnë afër 200 mijë persona të papunë, ndërsa për çdo muaj ofrohen nga 6000 deri 7000 vende të lira të punës që nuk mund të plotësohen. Paradoksi ku nga njëra anë të papunët ankohen se nuk mund të gjejnë punë, ndërsa nga ana tjetër - firmat ankohen se nuk mund të gjejnë punëtorë, nga ekonomistët shpjegohet me faktin se punëtorët janë të pakënaqur me nivelin e pagave që ofrohen.

Në ndërkohë, nga Qeveria thonë se me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për pagesën e pagës minimale në shtet, do të nxitet edhe spirala e rritjes së pagave të tjera. Njëherazi qëllimi i ndryshimeve ligjore është të nxitin punëdhënësit të paguajnë paga më të larta për punëtorët me qëllim të përmirësimit të mirëqenies, si dhe nxitet rritja ekonomike në Maqedoni.

Nga Ministria e Financave sh-

prehen se kësaj mase i parapriu rritja e pagës minimale në 12 mijë denarë në shtator të vitit të kaluar. Njëherazi, ajo paraqet vazhdimin e angazhimeve për rritjen e pagave dhe përmirësimin e standardit jetësor. "Për punëtorët që do të fitojnë rritje të pagës në raport me tremujorin e fundit të 2017-ës, shteti do të mbulojë 30 për qind të kësaj rritje, apo të rritjes së bruto pagës. Masa do të dedikohet punëtorëve që kanë pasur bruto pagë deri në 18 mijë denarë në tre muajt e fundit në vitin 2017. Përfitues do të jenë vetëm punëtorët, kompania e të cilëve nuk fiton ndonjë lehtësim apo ndihmë tjetër shtetërore. Ajo dedikohet për kompanitë me punë intensive, ku harxhimet për të punësuarit përbëjnë më shumë se 50 për qind e harxhimeve të përgjithshme dhe vetëm për firmat që nuk krijojnë profit të madh, apo për firmat që kanë fitim si përqindje e harxhimeve më të vogël se 10 për qind", thonë nga

Ministria e Financave. Përkrahja financiare do të kushtëzohet me qëllim që kompanitë të mbajnë punëtorin për të cilin fiton ndihmë së paku një vit pas ndërprerjes së ndihmës, nuk duhet t'ia ulë pagën minimum një vit pas skadimit të ndihmës dhe kompania nuk duhet të zvogëlojë totalin e të punësuarve gjatë fitimit të ndihmës financiare nga shteti.

Ndryshe, paga minimale në Maqedoni prej afër 200 euro filloi të paguhet në shtator të viti 2017, si premtim zgjedhor i ekzekutivit të ri. Me këtë zgjidhje ligjore, për herë të parë një shumë të tillë të rrogës mujore filluan të marrin edhe të punësuarit në industrinë e tekstilit, lëkurës dhe këpucëve që deri atëherë pranonin paga prej 9050 denarë. Nga ana tjetër, rroga mesatare e paguar në muajin prill të këtij viti ishte 23.942 denarë.

DEBAT PËR MODELIN E FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE

TË KONTROLLOHET FINANCIMI I PARTIVE

Shkup, 12 korrik - Rregullativa ligjore për financimin e partive politike është cilësore dhe e mirë. Problem është transparenca dhe kontrolli i procesit. Për përmirësimin e situatave është i nevojshëm përforsimi i kontrollit përmes krijimit të një institucioni kompetent. Financimi i partive politike mund të jetë dera përmes të cilës korrupsioni hyn në tërë sistemin. Këto janë qëndrimet e një pjese të pjesëmarrësve në tryezën e djeshme të rrumbullakët në temë "Përmirësimi i modelit të financimit të partive politike në Maqedoni", që u mbajt në organizim të Institutit demokratik kombëtar (IDK) dhe në bashkëpunim me Transparensi Interne-

shënal Maqedoni. Zgjidhjet ligjore janë të mira, tha Slagjana Taseva nga Transparensi Interneshënal Maqedoni dhe dihet se cilat janë mënyrat e ndaluara dhe të lejuara të financimit të partive politike. Ministria e Drejtësisë Renata Deskoska është e mendimit se zgjidhjet ligjore janë të mira, për çka, siç tha, flasin edhe vlerësimet e organizatave ndërkombëtare, midis të cilëve edhe GREKO, por se duhet të punohet në kontroll të madh të financimit të partive.

"Duhet të punojmë në përforsimin e mekanizmave për implementimin e normave ligjore, sepse në ligjet tona qartë është përshkruar se cilat janë burime të ndaluara të

financimit - nga jashtë vendit, nga institucionet shtetërore, institucionet publike...", tha Deskoska.

Përforsim i kapacitetit, sipas saj, do të thotë përforsim edhe i Komisionit antikorruption, Entit Shtetëror për Revizion, gjyqësi dhe prokurori.

Ato, tha ministrja Deskoska, janë institucione, të cilat mund të kontribuojnë për parandalimin e korrupsionit dhe financimin e paligjshëm të partive politike. Si mundësi edhe Taseva edhe Deskoska nuk e hodhën poshtë edhe financimin e partive politike vetëm nga mjetet buxhetore, por, theksuan se ende nuk mund të thuhet se është e mundur të realizohet.



Edhe Liza Klajn, konsultuese e IDK Maqedoni, mendon se kontrolli i financimit është mjet më i dobët dhe se duhet të punohet në përforsimin e tij.

Ligjet, thotë ajo, janë të mira,

por problem janë transparenca dhe mbikëqyrja. Për t'u përballur me problemin, është e nevojshme kohë dhe është e nevojshme të punohet në mënyrë themelore, hap pas hapi. (Z.V.)

DEURBANIZIMI I SHËNDETËSISË

ZONAT RURALE, JASHTË KUJDESIT PRIMAR

Banorët e zonave rurale janë të detyruar që të bëjnë dhjetëra kilometra për vizita mjekësore në qytetet më të afërta, kurse shteti shumë pak po punon që të instalojë mjekësinë primare në këto zona, në mënyrë që mjekët amë të cilët do të merreshin më seriozisht me historinë e sëmundjeve të pacientëve, duke filluar nga diagnostifikimi, ndjekja permanente e gjendjes shëndetësore, trajtimi adekuat dhe orientimi i tyre për mjekim të mëtejshëm



BEKIM TATESHI

Duhet punuar më shumë në sforcimin e mjekësisë familjare, sepse ky është një mekanizëm më adekuat i shtrirjes së mjekësisë primare edhe në zonat rurale. Mjeku sekondar dhe mjeku specialist nuk mund të angazhohet në pjesët e thella të vendit, kur këtë punë mundet me e kryer mjekësia primare. Që të arrihet kjo, edhe organizimi i studimeve duhet të bëhet në atë mënyrë që studentët në vitin e fundit të Mjekësisë të profilojnë për vendet e ardhshme të punës, duke u parapërgatitur për punësime të caktuara, ku gjithsesi do të bënte pjesë edhe shërbimi shëndetësor në zonat rurale

tuti Shëndetësor Publik në Shkup sqaron se shëndetësia në Republikën e Maqedonisë është e organizuar në disa nivele: Shërbimet primare shëndetësore, shërbimet sekondare në spitale dhe shërbime terciare në klinikat universitare. Sipas tij, problemi më i madh, kur flasim në nivelin profesional të shërbimeve shëndetësore, është i dukshëm në zonat rurale. Organizimi primar i mjekësisë në Maqedoni, sipas Memetit, është në shërbime preventive, të programit preventiv apo mjekëve amë. Mjekët amë janë hallka kryesore e shërbimit parësor të kontaktit me punëtorin, në këtë rast me eki-

pin. Shërbimet primare duhet të jenë në zona rurale, shprehet Memeti, ndonëse shërbimet aktuale në zonat rurale punojnë në bazë të rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të buxheteve që marrin nga Fondi për sigurim dhe shëndetësi për kokë pacientit.

Nëpër zona rurale, siç mund të jenë Karadaku, pjesa periferike e Tetovës me Malësinë e Sharrit, Mavrova, zonat e ndryshme të Dibres, ka mungesë të mjekëve amë, që do të thotë se çdo banor, i cili duhet të marrë shërbim shëndetësor primar duhet të shkojë në pjesët urbane.

Këtë na e konfirmon edhe dr.

Memeti dhe apelon që në këto zona të instalohet sa më shpejt shërbimi i mjekësisë primare, me fjalë të tjera aty mjeku amë duhet të jetë i përhershëm. Por kjo nuk mjafton nëse nuk rritet kapaciteti i shërbimeve në të gjitha pjesët të vendit, përfshi edhe zonat rurale, në mënyrë që banorët të mos jenë të detyruar të vizitohen nëpër institucionet shëndetësore urbane. Shërbimi mjekësor duhet të shkojë te pacienti, e jo anasjelltas, pacientët të bëjnë dhjetëra kilometra rrugë, kur këtë mund ta bëjnë në fshatin e tyre ku do të kenë qasje të drejtpërdrejtë të shërbimeve shëndetësore, përmes mjekëve amë të cilët do të merreshin më seriozisht me historinë e sëmundjeve të pacientëve, duke filluar nga diagnostifikimi, ndjekja permanente e gjendjes shëndetësore, trajtimi adekuat dhe orientimi i tyre për mjekim të mëtejshëm.

Pasqyra e shërbimit shëndetësor të një shteti është mjeku amë dhe pikërisht nëpër fshatra ka mungesë të këtij mjeku. Shërbimet primare janë të dhëna me koncesion, ndërkohë që shteti



SHABAN MEMETI

Problemi më i madh, kur flasim në nivelin profesional të shërbimeve shëndetësore, është i dukshëm në zonat rurale. Organizimi primar i mjekësisë në Maqedoni është në shërbime preventive, të programit preventiv apo mjekëve amë. Mjekët amë janë hallka kryesore e shërbimit parësor të kontaktit me punëtorin, në këtë rast me ekipin. Shërbimet primare duhet të jenë në zona rurale

duhet të zgjerohet rrjetin të shërbimeve primare shëndetësore, duke hapur ambulanca në zona rurale.

Në funksion të dërgimit të mjekut te pacienti e jo anasjelltas, oftamologu dr. Bekim Tateshi, është i mendimit se duhet punuar më shumë në sforcimin e mjekësisë familjare, sepse ky është një mekanizëm më adekuat i shtrirjes së mjekësisë primare edhe në zonat rurale. Mjeku sekondar dhe mjeku specialist nuk mund të angazhohet në pjesët e thella të vendit, kur këtë punë mundet me e kryer mjekësia primare, sqaron ai. Që të arrihet kjo, dr. Tateshi, propozon që edhe organizimi i studimeve të bëhet në atë mënyrë që studentët në vitin e fundit të Mjekësisë të profilojnë për vendet e ardhshme të punës, duke u parapërgatitur për punësime të caktuara, ku gjithsesi do të bënte pjesë edhe shërbimi shëndetësor në zonat rurale. Ai madje e konsideron të pafalshme mungesën e disa profileve mjekësore, siç është bie fjala gjinekologjia, apo anestezia, të cilat janë më se të domosdoshme në zonat më pak urbane, siç janë psh. Di-bra, Dellçeva etj.

Ndryshe, një pjesë e madhe e banorëve rural në Maqedoni, për shkak të qasjes së kufizuar të informacioneve mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre për shfrytëzim të shërbimeve shëndetësore, duke përfshirë këtu këshillat dhe planifikimin e familjes, në vend se të parandalojnë gjendje të caktuara, ata vizitojnë mjekun sipas nevojës, madje pasi që të shfaqen probleme të caktuar shëndetësore. Kjo, për shkak se në pjesën ku jetojnë nuk kanë ambulanta, respektivisht mjekë amë.

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 12 korrik - Ministria e Shëndetësisë, por edhe shumë politikanë (në platformat e tyre) zakonisht fokusohen në përmirësimin e cilësisë në shëndetësi, përmirësim të infrastrukturës, nivel më i lartë të pagave të punëtorëve dhe pajisje të reja nëpër spitale, duke u përqendruar vetëm në qytete.

Por, në realitet në zona të caktuara rurale në territorin e Republikës së Maqedonisë, banorët nuk janë në mbrojtje shëndetësore primare. Nuk kanë mundësi të ndjekin dhe bëjnë kontroll të gjendjes shëndetësore, këshillim për marrjen e masave parandaluese, çrënjosje dhe zbulim të hershëm të sëmundjeve dhe çrregullime të tjera të shëndetit. Në këto zona ndjehet edhe mungesa e dhënies së ndihmës emergjente shëndetësore, duke përfshirë këtu edhe automjetin sanitar që është më se i domosdoshëm, por edhe mjekim në ordinancë apo në shtëpinë e shfrytëzuesit etj.

Mjekët të vetëdijshëm për gjendjen aktuale në zonat rurale, rekomandojnë që duhet të sigurohet shërbimin e ndihmës së shpejt bashkë me transportin cilësor, përkujdesje dhe shërbime të tjera mjekësore, duke përfshirë këtu edhe fushën e shëndetit riprodhues dhe planifikimit të familjes. Po ashtu, të sigurohet edukimi me tema të ndryshme shëndetësore, ndërsa të ofrohet edhe mbrojtje shëndetësore përkatëse për të gjithë banorët, veçmas gratë.

Shaban Memeti, drejtor i Insti-

MPPS: PUNOHET NË ZBARDHJEN E RASTIT ME FOSHJËN E KAFSHUAR NË KOPSHT

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale kumtoi se është e njohur me rastin për foshnjën 11-muajshe e cila është kafshuar në kopshtin e fëmijëve "Rade Jovčevski Korçaqin", dhe po punon në zbardhjen e rastit. Nga Ministria nuk përjashtojnë mundësinë për procedurë disiplinore nëse ekzistojnë elemente për kundërvajtje të tillë. "Sektori për mbikëqyrje inspektuese për mbrojtje të fëmijëve tashmë është në terren dhe po punon në zbardhjen e rastit, përkatësisht për atë se si u shkaktua lëndimi i fëmijës dhe nëse ekziston



dyshimi në pajtim me Ligjin do të ngrihet procedurë për përcaktimin e kundërvajtjes disiplinore", theksojnë nga MPPS. Njëherit, nga Ministria sqarohet se për shkak të numrit të pakësuar të fëmijëve në institucionet publike për fëmijë-kopshte të fëmijëve, në periudhën verore është praktikë shumëvjeçare që fëmijë të grupeve të ndryshme, në përputhje me moshën, të bashkohen në një grup më të vogël, por kjo, theksojnë, nuk nënkupton rritjen e numrit të fëmijëve nëpër grupe.

Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe i pranishëm në përrurimin e Kabineti për ushqyerjen klinike dhe kapsulën e re endoskopike, tha se janë marrë të gjitha masat për promovimin e kapsulës endoskopike jo vetëm për pacientët, por për të gjithë qytetarët e vendit

EKZAMINIMI I SËMUNDJES SË ZORRËVE

VJEN KAPSULA E RE ENDOSKOPIKE

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 12 korrik - Në Klinikën Universitare për gastroenterohepatologji u lëshua në përdorim Kabineti për ushqyerjen klinike dhe kapsulën e re endoskopike për ekzaminimin e sëmundjes së zorrëve. Sipas përfaqësuesit të këtij kabineti, te të sëmurët do të futet një instrument (endoskopi) përmes anusit (ose gojës) drejt zorrës. Zorra do të mund të vëzhgohet nga brenda përmes një kamere, ndërsa me ndihmën e instrumenteve specialë do të hiqen (shkëputen) inde për prove.

Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe i pranishëm në përrurimin e Kabineti për ushqyerjen klinike dhe kapsulën e re endoskopike, tha se janë marrë të gjitha masat për promovimin e kapsulës endoskopike jo vetëm për pacientët, por për të gjithë qytetarët e vendit. Ku kjo kapsulë është metodë bashkëkohore që përdoret në shumë vende të zhvilluara të botës. Lehtëson dhimbjet dhe ajo që është e rëndësishme pranohet që në fazën e hershme. Ministria e Shëndetësisë, paralajmëroi Filipçe do të bashkëpunojë edhe në të ardhmen me, donatorin, Fondin për sigurim shëndetësor, me qëllim për mbështetje që të zbatohen të gjitha metodat e reja në Klinikat tona. Si fillim shtoi ai për të përmirësuar qasja e qytetarëve drejt institucioneve shëndetësore, por edhe të përmirësohen kushtet në shëndetësi.



Nga Klinika Universitare u tha se kjo është një mundësi e mirë e zbulimit të tumoreve në zorrë. Ku nga 13 kapsula që janë përdorur, janë diagnostifikuar 2 tumore në zorrë.

Deri më tani Klinika Universitare për gastroenterohepatologji e ka promovuar këtë metodë dhe e ka praktikuar nga qershori i vitit 2012 deri në qershor të vitit 2015, nga ku edhe janë kryer 27, prej të cilave 19 studime me rezultat të kapsulës endoskopike. Ata e cilësojnë rikthimin e kësaj metode si një hap të mirë për shëndetësinë dhe të sëmurët. Në vitin 2001 për herë të parë është përdorur në Amerikë, ndërsa në Maqedoni në vitin 2012. Sipas mjekëve, kjo kapsulë do ti ndihmojë mjekët të përcaktojnë se çfarë shkakton

shenja dhe simptoma që ndikojnë në tretjen e ushqimit, të tilla si vjellje, dhimbje barku, vështirësi në gjellitje, gjakderdhje gastrointestinal, etj. Përmes kësaj diagnoze mjekët do të përdorin endoskopinë te pacienti për të mbledhur mostrat të indeve (biopsi) për të provuar sëmundjet si anemi, diarre, gjakderdhje, kancerin në sistemin e tretjes, etj.

Të gjithë pacientët, të cilët do të hospitalizohen në Klinikën Universitare do të merren masa për kontroll. Për moment në Klinikë ka 4 pacientë, të cilët janë tërhequr nga pediatria. Ka pacientë që marrin vetëm ushqim artificial, të cilët përmes metodave të reja mund të ndihmohen. Përmes Fondit për sigurim shëndetësor klinika Universitare ka siguruar 25 kapsula. Çmi-

mi i kapsulës endoskopike është e njëjtë në gjithë botën dhe arrin shumë 700 euro. Më herët qytetarët e Maqedonisë kanë përdorur kapsulën endoskopike duke u vizituar në shtetet e jashtme. Nëse kjo metodë e kapsulës, e cila kushton, do të liron pacientët nga pagesa, Filipçe tha se sipas programit qeveritar që pritet lirim nga pagesa në spitale nga Janari i vitit 2019, kjo varet nga buxheti që Fondi për sigurim shëndetësor të ofrojë në klinika. Ai gjithashtu paralajmëroi se bëhet një tender për higjienën në Klinika dhe se punohet për përmirësimin e kushteve në shëndetësi dhe rritjen e pagave dhe numrin e kuadrit mjekësor. Si dhe kërkesat e tjera që rekomandohen nga mjekët dhe organizatat.

Shkup, 6 aksidente me dy të lënduar rëndë

Shkup, 12 korrik - Dy persona janë lënduar rëndë, ndërsa gjashtë prej tyre kanë marrë lëndime të lehta trupore në shtatë prej gjithsej 12 aksidenteve që gjatë 24-orëve të kaluara ndodhën në rrethinën e SPB-së së Shkupit. Policia rrugore gjatë 24-orëve të kaluara ka sanksionuar 61 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, ndërsa nga komunikacioni janë përjashtuar 18 shoferë. Gjithnjë, sipas raportit policor, nga komunikacioni janë përjashtuar pesë shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, nëntë që kanë drejtuar automjetin para se të pajisen me patentë shoferi, katër shoferë fillestarë dhe 134 vetura ta paregjistruara. Në mënyrë jo të drejtë janë parkuar 45 vetura, ndërsa shërbimi i karrotrecit ka ngritur 54 automjete. Janë sanksionuar edhe dy këmbësorë të cilët nuk kanë kaluar rrugën në vijat e bardha dhe dy të tjerë kanë kaluar udhëkryqin në dritën e kuqe. Janë sanksionuar edhe dy shoferë për rreshtim jo të rregullt, katër shoferë të cilët nuk u kanë dhënë përparësi kalimi veturave dhe 17 shoferë të motoçikletave dhe biçikletave për mospërdorim të helmetës mbrojtëse.

Tetë ditë paraburgim për Stojçevin



Strumicë, 12 korrik - Gjykatësi në procedurën paraprake në Gjykatën Themelore në Strumicë i ka shqiptuar masën e paraburgimit tetëditor kryetarit të Novo Sellës, Boro Stojčev. Masë e njëjtë u është shqiptuar edhe tre personave të tjerë, ndërsa një personi i është marrë dokumenti i udhëtimit dhe duhet që ai një herë në javë të paraqitet në Gjykatën e Strumicës. Kryetari i Novo Sellës dhe të dyshuarit e tjerë për kontrabandë me cigare, masën e paraburgimit do ta vuajnë në burgun e Prilepit. Mbrëmë rreth orës 19 në vendkalimin ilegal të kufirit mes Maqedonisë dhe Bullgarisë, në afërsi të fshatit Badilen, policia ka arrestuar pesë persona për tentim të kontrabandës me rreth 3.300 paketa të cigareve në vlerë prej 3.245.589 denarësh. Prokuroria Themelore Publike në Strumicë i akuzon për veprën e kryer penale kontrabandë për të cilën është paraparë dënim me burg prej gjashtë muajsh deri në 5 vjet.

Vera e Kulturës Tetovare me aktivitete sportive

Tetovë, 12 korrik - "Vera e Kulturës Tetovare 2018" këtë vit në Tetovë ka filluar nga katër korriku dhe do të zgjasë deri më 2 gusht. Në ndërkohë, këtë vit risi janë edhe aktivitetet sportive kurse këtë të diel do të ketë edhe gara në motoçikleta. Këtë e kanë bërë të ditur organizatorët e manifestimit në Vodno të Shkupit, të cilët prej këtij viti do të organizojnë gara në motoçikleta në Kodrën e Diellit. "Këtë manifestim e kemi menduar si komponent të fortë sportive dhe argëtuese. Pas përfundimit të garave në Kodrën e Diellit, do të organizojmë një piknik dhe eko-

festival, ku do të shpallen edhe fituesit në të gjitha disiplinat dhe do të ketë një manifestim të pasur argëtues", tha Aleksandar Georgievski. Një ndër aktivitetet kryesore sportive që do të mbahet këtë vit është "I pari deri në majin e Sharrit". Sipas Jeton Pustines, ky aktivitetet për herë të parë është në agjendën e manifestimit Vera e Kulturës Tetovare dhe do të ketë gara në tre disiplina - edhe atë biçiklizëm malor, vrapim malor dhe biçiklizëm rrugor. "Kryesorja është të promovohen bukuritë natyrore të Malit Sharr, të cilët i kemi të shumta dhe për të cilët ne

si qytetarë bëjmë shumë pak. Në këtë edicion të Vera e Kulturës Tetovare 2018 element kryesor do të jetë sporti. Krahas futbollit për femra, do të kemi edhe spektaklin e boksit, do të kemi edhe kampingjet që do ti organizojmë në fshatrat e Malësisë së Tetovës dhe shumë e shumë ngjarje tjera" tha Pustina, koordinator i aktiviteteve për manifestimin Vera e Kulturës Tetovare. Sipas organizatorëve, manifestimi "I pari deri në majin e Sharrit" deri më tash është organizuar në Shkup, ndërsa këtë vit edhe në Malin Sharr. (U.H)



Të shmangen marrëveshjet e rreme me Moskën



Nga
Janusz BUGAJSKI

Në takimin e tij të ardhshëm në Helsinki të Finlandës, presidenti Donald Trump duhet të përqëndrohet tek veprat dhe jo fjalët e Vladimir Putinit. Përndryshe, Shtëpia e Bardhë, do të përsërisë gabimet e administratave të mëparshme amerikane.

Në skenarin e zakonshëm, çdo president i ri i SHBA-së beson se ai mund të jetë më i suksesshëm se paraardhësi i tij, në krijimin e një partneriteti me udhëheqësin rus. Besimi është shpallur, premtimet janë bërë, marrëveshjet janë gati për t'u arritur, duke anashkalluar aktet e mëhershme të agresionit të Moskës kundër fqinjëve të saj. Kjo detantë e re i garanton Kremlinin qetësinë e duhur, për t'u përgatitur për ofensivën e tij të ardhshme, e cila do të çojë në një tjetër tensionim të marrëdhënieve dypalëshe, dhe gjithçka nis pastaj nga e para. Në vend se të përsëritet një cikël që e lejon Rusisë t'ia hedhë paq pas revizionizmit të saj territorial, dhe të krijojë terrenin për debstatitete të mëtejshme, administrata amerikane duhet të kërkojë rrugët më efektive për të mbajtur Moskën nën kontroll, në një kohë që avancion interesat e veta dhe të aleatëve të saj.

Në tërësi, ekzistojnë dy strategji kundërta për politikën amerikane ndaj Rusisë së Putinit: akomodimi perandorak ose këmbëngulja transatlantike. Në strategjinë e parë, politikëbërësit llogarisin se një afrim me Moskën do të zvogëlojë rrezikun e konfliktit mes fuqive të mëdha, dhe do të sigurojë nisma konstruktive të përbashkëta. Mjerisht, ata që e mbështetin një politikë të tillë, veprojnë mbi bazën e dy premisave të gabuara: atë sipas së cilës Kremlin është i interesuar për kompromise të përhershme, dhe se Rusia ka disa interesa të veçanta ndaj satelitëve të dikurshëm, të cilat Uashingtoni duhet t'i njohë dhe pranojë.

Në realitet, dredhia negociuese e Kremlinin, nuk synon të sigurojë përfitime reciproke apo objektiva "të favorshëm". Ajo bazohet në llogaritjet e lojërave me shumë zero ose në formulën fitues-humbës, në të cilin Moskës vlerëson se do të përfitojë nga një pezullim i përkohshëm i armiqësisë me Perëndimin, edhe nëse nuk do të jenë arritur të gjitha synimet e saj ekspansioniste. Ky është një aplikim i diktatit të Leninit, për të lëvizur "dy hap përpara, dhe një hap pas", dhe nuk është asgjë më shumë se një pauzë taktike para ofensivës së ardhshme. Supozimi i dytë i gabuar, është se Ru-

sia ka "interesa kombëtare" jashtë kufijve të saj.

Ai zvogëlon pavarësinë dhe sigurinë e të gjitha shteteve të Europës Qendrore dhe Lindore, dhe fuqizon Moskën për t'u angazhuar në aventura e saj perandorake. Politika e jashtme e Rusisë që kur Putin mori pushtetin gati 20 vite më parë, përfshin përcaktimin e politikave të huaja dhe të sigurisë së fqinjëve të saj, duke rregulluar shtrirjen e territoreve të tyre, dhe diktuar aleancat e tyre ndërkombëtare. Janë bërë sugjerime për një "marrëveshje të madhe" midis Trump dhe Putin, që do të lejonte Moskën të pretendojë sundimin e saj në të gjithë territoret ish-sovjetike, në këmbim të premtimeve të përhershme për të bashkëpunuar në fusha të tjera. Paradoksisht, njohja e "interesave asimetrike" të Rusisë ndaj fqinjëve të saj, ka më shumë gjasa të rezultojë në një përplasje me NATO-n. Nëse Kremlin është i bindur se ka dorën e lirë për të ndërhyrë tek vendet përgjatë kufijve të vet, mund të bëjë llogari të gabuara, dhe të provokojë një përplasje të drejtpërdrejtë me shtetet anëtare të aleancës.

"Pazari i madh", do të shndërrohet në një dështim të madh, duke rritur shanset që Uashingtoni të përfshihej në një konflikt me Moskën. Në kontrast me një përjasje vetë-mpo-

shtetëse ndaj Rusisë, ndihma transatlantike do të forcojë Aleancën dhe interesat kombëtare të Amerikës. Strategjia e re e Sigurisë Kombëtare e Shteteve të Bashkuara, pohon se Rusia është një rivale dhe një konkurrente, që synon të dobësojë ndikimin ndërkombëtar të Uashingtonit, dhe të ndajë SHBA-në nga aleatët dhe partnerët e saj. Në dritën e këtij vlerësimi të matur gjeopolitik, strategjia e Uashingtonit duhet të pengojë Kremlinin nga ndërmarrja e veprimeve sulmuese në Europë, të cilat mund të provokojnë një reagim më të ashpër amerikan. Për të arritur këtë objektiv, lipset të konsolidohet mbrojtja e aleatëve kryesorë si Polonia, Rumania, dhe tre shteteve baltike. Disa masa tashmë janë marrë, për të mbrojtur në mënyrë më efektive sigurinë e këtyre aleatëve të pambrojtur të NATO-s, duke përfshirë edhe vendosjen e Pranisë së Pararojës së Përfortuar (eFP).

Por më shumë duhet të arrihet në vitet e ardhshme. Në veçanti, NATO duhet të rrisë aftësitë e saj për t'iu përgjigjur shpejt çdo lëvizjeje të mundshme ushtarake nga Moskës. Përveç kësaj, Uashingtoni duhet të marrë parasysh përparësitë afatgjata të krijimit të një pranije më të përhershme ushtarake në Poloni, siç e ka kërkuar vetë Varshava kohët e fundit. Ndërkohë, është i nevojshëm edhe një

Duke negociuar nga pozitat e forcës ushtarake, Trump duhet të tregojë autoritetin e tij, duke dhënë sinjale të qarta të asaj që Uashingtoni pret nga Moskës, duke përfshirë një tërheqje nga Ukraina, dhe duke i dhënë fund kërcënimeve ushtarake kundër të gjithë aleatëve të NATO-s



angazhim më i fortë për forcimin e sovranitetit shtetëror dhe sigurisë kombëtare të të gjitha vendeve të ish-blllokut sovjetik që kufizohen me Rusinë, veçanërisht partnerët e NATO-s si Ukraina, Gjeorgjia, Moldavia dhe Azerbajxhani, dhe përfshirja e gjithnjë e më shumë aleatëve të lëkundur rusë, si Bjellorusia dhe Armenia. Një luftë e përtërirë që përfshin ndonjërin prej këtyre shteteve, mund të destabilizojë rajonin më të gjerë, dhe të vërë nën presion aleatët e SHBA-së. Një angazhimi më i madh politik, ushtarak dhe ekonomik, do të shërbejë si një pengesë për ndërhyrjen e Kremlinin.

Në thelb, s'ka asgjë të keqe në takimin me udhëheqësin rus, për sa kohë që Trump nuk i beson verbërisht fjalëve të Putinit, apo të bjerë në kurthin e Kremlinin për të dobësuar Europën, dhe zbehur lidhjen transatlantike. Duke negociuar nga pozitat e forcës ushtarake, Trump duhet të tregojë autoritetin e tij, duke dhënë sinjale të qarta të asaj që Uashingtoni pret nga Moskës, duke përfshirë një tërheqje nga Ukraina, dhe duke i dhënë fund kërcënimeve ushtarake kundër të gjithë aleatëve të NATO-s. Në të kundërt, ashtu si gjatë administratës së Obamës, Shtëpia e Bardhë do ta gjejë sërish veten të paralizuar, kur Putin të vendosë të nisë një sulm të ri ndërkombëtar. (bota.al)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovrasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 12 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Edward OWEN

Si NATO mund të shmangë një Luftë të Re të Ftohtë

Më 11-12 korrik, NATO do të mbajë një samit në Bruksel për të diskutuar një rrugë të re strategjike për aleancën. Shumëkush, shpreson për lidhje më të forta mes aleatëve perëndimorë, pas një periudhe të mos-funksionimit politik. Ndërkohë, Rusia dhe Kina po forcojnë marrëdhëniet mes tyre, dhe janë gati të sfidojnë strukturën unipolare të pushtetit, që Perëndimi ka gëzuar që nga shembja e Bashkimit Sovjetik.

Megjithatë, kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht fillimin e një lufte të re të ftohtë, pasi NATO dhe Rusia kanë ende një mundësi për t'i dhënë fund tensioneve. Një shumëllojshmëri faktorësh politikë dhe ekonomikë, si dhe një kohë e përshtatshme, kanë krijuar stimuj për të dyja palët, për të krijuar dialog dhe për të punuar drejt bashkëpunimit. Samiti i korrikut, do të jetë një mundësi për udhëheqësit e NATO-s, që të bëhen bashkë dhe hartojnë një politikë të qartë të sigurisë, për të forcuar Europën. Agjenda kryesore e takimit, do të jetë krijimi i një strategjie për të përmirësuar gatishmërinë ushtarake dhe sigurinë në shtetet baltike, duke ruajtur gjithashtu hapjen ndaj dialogut dhe marrëdhënieve më të mira me Moskën.

Në vitin 2017, NATO vendosi një prani të zgjeruar ushtarake në shtetet baltike, Poloni dhe rajonin e Detit të Zi, për të penguar agresionin rus, si dhe për të promovuar mbrojtjen kolektive. Më së fundmi, më 3 qershor 2018, rreth 18.000 trupa të NATO-s, morën pjesë në stërvitjen e përvitshme ushtarake në Poloni "Saber Strike", të udhëhequr nga SHBA-ja, për të përmirësuar gatishmërinë dhe fortifikimet mbrojtëse në Evropën Lindore. Anëtarët e NATO-s, do të synojnë gjithashtu të krijojnë një Komandë të re të Forcave të Bashkuara të Atlantikut, në Bregun Lindor të Shteteve të Bashkuara, një komandë logjistike në Gjermani, dhe një qendër të sigurisë kibernetike.

Ndërsa NATO, po përpiqet të përmirësojë marrëdhëniet e saj të brendshme, dhe strategjinë e saj për t'u mbrojtur ndaj kërcënimit rus në Evropën Lindore, Rusia ka kthyer kokën nga Kina për mbështetje ekonomike dhe ushtarake. Në fillim të qershorit, presidenti rus Vladimir Putin dhe presidenti kinez Xi Jinping u takuan, së bashku me disa liderë të tjerë, në Samitin e Organizatës së Bashkëpunimit të Shangait 2018 (SCO). SCO përbëhet nga 8 shtete anëtare, përfshirë Kinën, Rusinë, Indinë, Pakistanin dhe disa vende ish-aziatike të bllokut sovjetik.

Samiti i qershorit, ngjalli një



optimizëm të konsiderueshëm mbi përmirësimin e marrëdhënieve në Lindje; ndërsa vendet perëndimore bënë një hap prapa në samitin e G7-ës në Kanada. SCO-ja, është më e bashkuar dhe më e sigurt, dhe ka gjasa të jetë një rival e mundshme e NATO-s. Disa madje, do të argumentojnë se SCO përbën tashmë një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj sigurisë perëndimore.

Gjithsesi ajo, nuk është ende e unifikuar si NATO, pasi shtetet anëtare përballen me një sërë dallimesh historike, kulturore dhe identitetare. Për shembull, Pakistani dhe India, dy anëtarët më të rinj, janë rivalë rajonale, ndërsa India kundërshton hapur Nismën kineze të Brezit dhe Rrugës, që do të forcojë fuqinë ekonomike globale të Kinës. Sidoqoftë, sukcesi i mundshëm i SCO, nxjerr në pah marrëdhënien në zhvillim midis Rusisë dhe Kinës. Të dyja vendet kryesore të SCO, janë në shumë aspekte të ngjashme, dhe interesat e tyre përkohë shumë shpesh me njëra-tjetrën. Për më tepër, të dyja vendet kanë interesa të ndërsjellë në kufizimin e ndikimit amerikan, si dhe zhvendosjen e strukturës së fuqisë globale nga ajo e dominuar nga diplomacia perëndimore.

Kjo marrëdhënie e ngrohtë midis Rusisë dhe Kinës, nuk është e re. Tek e fundit, të dyja fuqitë

Nëse NATO ia del të zbusë partneritetin në rritje të Kinës me Rusinë, kjo do të dobësojë aftësinë e Kinës për të konkurruar me Perëndimin për ndikimin global. Për këtë arsye, samiti i NATO-s duhet t'i japë përparësi përpjekjeve për të vazhduar dialogun pozitiv me Rusinë, pasi ka të ngjarë që Rusia të jetë e gatshme të negociojë me Perëndimin



ndajnë një kufi të gjatë prej 3500 km, dhe kanë ekonomi të dominuara nga kompani shtetërore dhe oligarkë. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, tregtia midis Rusisë dhe Kinës ka shënuar një rritje prej 6 herësh, dhe vitin e kaluar të dyja vendet nënshkruan marrëveshjen më të madhe të tregtisë së gazit në histori. Ato po rritin në mënyrë të vazhdueshme edhe bashkëpunimin e tyre ushtarak. Rusia i shet Kinës çdo vit mbi 1 miliardë dollarë në armatime. Nuk është për t'u habitur se përse Rusia dhe Kina, do të synojnë të formojnë një aleancë strategjike në Lindje.

Të dyja vendet, janë të njohura për rezistencën e tyre ndaj dominimit perëndimor, ndërsa Moskë dhe Pekini kanë ambicet e tyre për të zgjeruar shtrirjen globale. Ky partneritet politik ishte i pashmangshëm, duke pasur parasysh ngjarjet e viteve të fundit. Pasi marrëdhëniet diplomatike dhe ekonomike midis Rusisë dhe Perëndimit u përkeqësuan në vitin 2014, Rusia u izolua plotësisht nga vendet e NATO-s. Kjo krijoi mundësinë që aleate e ngushtë e saj të bëhej Kina.

Koha e nacionalizmit të ringjallur të Rusisë, përputhet ndërkohë me "oreksin" e Kinës për modernizimin ushtarak dhe përhapjen e ndikimit global. NATO duhet të ndërmarrë hapa efektivë, për të ndërthurur një dia-

log konstruktiv me Rusinë, dhe të përpiqet ta rilidhë Moskën me Perëndimin. Është në interesin e NATO-s dhe Rusisë, që të zbusin tensionet mes tyre, dhe të zhvillojnë një rrugë për marrëdhënie të forta ekonomike. Rusia duhet të negociojë një lehtësim nga sanksionet perëndimore, të cilat e kanë dëmtuar rëndë ekonominë e saj. Përveç kësaj, partneriteti në rritje me Kinën, nuk është domosdoshmërisht opsioni më i mirë për Kremlinin. Pekini përbën një kërcënim për ndikimin e Moskës në Azinë Qendrore. Interesi i rritur i Kinës për të zhvilluar infrastrukturën në vendet e ish-bllokut sovjetik të rajonit, shkel në sferën e influencës së Rusisë, dhe mund të shkaktojë shqetësime në Moskë.

Anëtarët e NATO-s duhet të përpiqen gjithashtu të zbusin shqetësimet e sigurisë në Evropën Lindore, dhe njëkohësisht të forcojnë bashkëpunimin e brendshëm. Nëse NATO ia del të zbusë partneritetin në rritje të Kinës me Rusinë, kjo do të dobësojë aftësinë e Kinës për të konkurruar me Perëndimin për ndikimin global. Për këtë arsye, samiti i NATO-s duhet t'i japë përparësi përpjekjeve për të vazhduar dialogun pozitiv me Rusinë, pasi ka të ngjarë që Rusia të jetë e gatshme të negociojë me Perëndimin.


(International Policy Digest)



Heqja e qimeve nga hunda mund të shkaktojë edhe vdekjen


Duket se disa gjëra të cilat në përditshmëri nuk u kushtojmë aspak vëmendje nga ana shëndetësore, mund të rezultojnë fatale për ne. Shpesh mjekët janë shprehur se të depiluarit në pjesë të caktuara në trup është i rrezikshëm dhe nuk duhet bërë. Por e dini që të hiqni qimet nga hunda mund të shkaktojë edhe vdekjen? Ja përse:

Fytyra jonë ka një pjesë që



quhet "trekëndëshi i vdekjes", në të cilin ka shumë arterie dhe vena venoze. Kjo pjesë shumë delikate fillon nga pjesa e sipërme e hundës dhe përfundon në cepat e buzëve.

Duke shkukur qimet nga hunda, ju mund të keni dëmtuar njëkohësisht një venë venoze, dhe pjesa e dëmtuar bëhet shumë e ndjeshme dhe delikate duke mbledhur bakterie të rrezikshme për imunitetin. Rekomandohet që në këtë pjesë të trupit, qimet të shkurohen por në asnjë mënyrë të shkullen.



TA SHËROJMË PLAKJEN NJËHERË E PËRGJITHMONË!

Përsheptuesi i njohur i biznesit Y Combinator e ka lansuar YC Bio, një linjë specifike financimi për kompanitë bioteknike. Fokusi fillestar do të jenë kompanitë që synojnë t'i ndihmojnë njerëzit të jetojnë jetë më të gjatë dhe më të shëndetshme

Përsheptuesi i biznesit Y Combinator është i njohur për vendimarrje intriguese investuese dhe shpesh të mençur. Ata ofruan mbështetje të hershme për kompanitë tashmë të njohura, si Airbnb dhe Coinbase, dhe gjithashtu kanë mbështetur sipërmarrje të vogla eksperimentale të përqendruara në çdo gjë, nga shkenca e materialeve deri tek materialet e bartshme për lopët. Më 11 janar, Sam Altman, presidenti i Y Combinator, e paralajmëroi YC Bio, një eksperimenti i ri i cili do t'i financojë kompanitë e shkencës së jetës. Për shkak të



madhësisë së fushës së biologjisë, Altman shpjegoi se Y Combinator mendonte se kishte më shumë kuptim të përqendroheshin në një fushë të caktuar njëkohësisht. Ai tha se kompania gjithashtu ka konstatuar se "kompanitë që punojnë në fusha të ngjashme marrin shumë vlerë ngaqë janë pranë njëra-tjetrës". Fusha e parë e fokusit për YC Bio është "mirëqenia shëndetësore" dhe sëmudjet e lidhura me moshën. Mirëqenia shëndetësore fokusohet në idenë se mjekësia nuk duhet vetëm t'i ndihmojë njerëzit të jetojnë më gjatë, por t'ua mundësojë atyre njerëzve të gëzojnë shën-

det të mirë dhe cilësi të lartë të jetës gjatë viteve të tyre.

"Mendojmë se ekziston një mundësi enorme për t'i ndihmuar njerëzit të jetojnë më të shëndetshëm për më shumë kohë dhe se kjo mund të jetë një nga mënyrat më të mira për ta trajtuar krizën tonë shëndetësore", shkroi Altman në artikullin e tij të blogut duke e paralajmëruar nismën në fjalë. Ashtu si linja e saj YC AI, e cila i financon ekskluzivisht kompanitë që përqendrohen në inteligjencën artificiale (AI), kompanitë që marrin pjesë në YC Bio fillimisht do të kalojnë nëpër grupin e rregullt të

përsheptuesit përpara se ta marrin ofertën e tyre. Në vend të marrëveshjes standarde të YC prej 120,000 dollarësh në shkëmbim të pronësisë prej 7 për qind, kompanitë e YC Bio do ta pranojnë një ofertë prej midis 500,000 dhe 1 milion dollarësh për një pronësi ndërmjet 10 dhe 20 për qind. Përveç këtij financimi "fillestar", kompanitë e YC Bio do të kenë edhe hapësirë të lirë laboratorike dhe marrëveshje të tjera të veçanta, si p.sh. qasja në një "gamë të gjerë ekspertësh", sipas Altman. Në vitin 2014, Y Combinator e financoi kompaninë e tyre e parë të bioteknologjisë, Ginkgo Bioworks, dhe kjo kompani kohët e fundit i mblodhi 275 milionë dollarë për ta ndërtuar objektin e vet të ri të prodhimit, duke e sjellë vlerën e totale në 1 miliard dollarë. Ky sukses i kaluar është veçanërisht inkurajues, duke qenë se një nga pionierët në hulumtimin anti-plakje kohët e fundit tha se, ndërkohë që fusha është e mbushur me ide premtuese, nuk ka pasur fonde të mjaftueshme për t'i lehtësuar hulumtimet solide. Ndoshta YC Bio do të jetë në gjendje ta mbushë këtë zbrazëtim.

Mungesa e ujit në trup ndikon në të menduar

Studiuesit zbuluan se humbja e lëngjeve e cila korrespondon me dy për qind të peshës së sportistëve rezulton në çrregullime të funksionit njohës. Shkencëtarët kanë gjetur se dehidrimi shkakton probleme sidomos në detyrat që kërkojnë vëmendje, dhe të ashtuquajturin funksion ekzekutiv, i cili përfshin, për shembull navigim të hartave, drejtshkrim, aritmetikë ose korrigjim të tek-

steve. Ronald Rot, profesor i mjekësisë emergjente në Universitetin e Medicinës në Pitsburg, thotë se simptomat e dehidritimit janë impotencia e përgjithshme, dobësia e muskujve, zvogëlimi i sekretimit të urinës, konfuzioni. Për ditët e ngrohta, rekomandon një plan trajnimi në mënyrë që dehidratimi të mos çojë në vendime të gabuara. Ai paralajmëron dhe nuk duhet konsumuar sasi të

tepërt të ujit pasi kjo mund të çojë në një gjendje të rrezikshme - hiponatremi.

"Është e rëndësishme të dimë se si ta rregullojmë marrjen dhe humbjen e lëngjeve", thotë Rot. Ai sugjeron kontrollin e ngjyrës së urinës e cila është shumë e ndritshme nëse merret shumë ujë dhe e verdhë intensive ose e errët nëse personi është i dehidratua.



A e parandalon rripi i sigurisë dëmtimin e mëlçisë gjatë aksidenteve?

Përdorimi i rripit të sigurisë zvogëlon rrezikun e dëmtimit të mëlçisë të njerëzit me më shumë se 20 për qind, tregon një hulumtim i këtij viti.

Ndër personat e përfshirë në aksidente në rrugë, ata që përdorin rripat e sigurisë kanë 21 për qind më pak të ngjarë të vuajnë dëmtime të rënda të mëlçisë, që rritet deri në 26 për qind kur kombinohet me jastëkët e ajrit. Mëlçia është një nga organet më të lënduara gjatë përplasjeve në rrugë, me dëmtime të rënda duke vrarë rreth 15 për qind të të sëmurve, thuhet në hulumtim.

Autori i hulumtimit, Audrey Renson nga spitali Langone



Brooklyn, tha se përdorimi i rripit të sigurisë është i lidhur me vdekshmërinë më të ulët në një aksident makine.

"Ndonëse disa mund të mar-

rin në konsideratë këtë kuptim të mirë, ka ende disa polemika se mbajtja e rripave të sigurisë janë të dëmshme dhe se të kesh një jastëk ajri nënkupton se nuk ki ne-

vojë të vësh një rrip sigurie", tha ai. Studiuesit besojnë se gjetjet e tyre e përforcojnë rëndësinë e rripave të sigurisë.

Dr. Eileen Metzger Bulger, kryetare e Kolegjit Amerikan të Kirurgjisë për Traumë, e cila nuk ishte përfshirë në studim, thotë se mëlçia dhe shpretka janë organet më të plagosura pas aksidenteve në rrugë.

"Të dyja mund të shkaktojnë gjakderdhje të rëndë, por shpretka mund të hiqet nëse është e nevojshme gjatë operacionit, gjë që kontrollon gjakderdhjen. Mëlçia, megjithatë, është kritike për jetën dhe nuk mund të hiqet", tha ajo.

BUZËQESHNI GJITHMONË NË FOTON E PASAPORTËS TUAJ!



Studimi zbuloi se disa njerëz kishin vështirësi në identifikimin e njerëzve kur shprehja e tyre e fytyrës ishte neutrale dhe se ishte më e lehtë të përputheshin me fotot ku individit po qeshte në të dyja fotografitë

Sipas një studimi të ri, tashmë duhet të buzëqeshni gjithmonë në foton e pasaportës tuaj të ardhshme. Studimet e fundit kanë zbuluar se duke qeshur në foton e pasaportës tuaj mund të pengojë mashtrimin e identitetit. Hulumtimet e tyre kanë studiuar shumë mënyra për identifikimin më të mirë të njerëzve përmes fotografive - një çështje e rëndësishme kjo për autoritetet që përpunon të identifikojnë pasaportat e falsifikuara.

Studimi zbuloi se disa njerëz kishin vështirësi në identifikimin e njerëzve kur shprehja e tyre e fytyrës ishte neutrale dhe se ishte më e lehtë të përputheshin me fotot ku individit po qeshte në të dyja fotografitë

shtrirësi në identifikimin e njerëzve kur shprehja e tyre e fytyrës ishte neutrale dhe se ishte më e lehtë të përputheshin me fotot ku individit po qeshte në të dyja fotografitë. "Foto ID është një pjesë e rëndësishme e jetës sonë dhe megjithatë ne e dimë se truri i njeriut ka një kohë të vështirë në përputhjen me fotot e njerëzve dhe në fotot që përputhen me personin e vërtetë", tha dr. Mila Mileva nga departamenti i psikologjisë në Nju Jork.

"Mashtrimi i identitetit është një problem i vërtetë në shumë nivele, prandaj është e rëndësishme që të bëjmë më shumë kërkime në këtë fushë për të parë se si mund të përmirësojmë metodat e identifikimit". Studimi përmbante tre teste kryesore. Në testin e parë, pjesëmarrësve iu kërkua të përputheshin me shprehjet neutrale të fytyrës, e cila ishte e ngjashme me fotografinë e pasaportës, me një foto të të njëjtit person duke qeshur.

Testi i dytë u kërkoi atyre që të përputheshin me një fytyrë neutrale me njerëz të qeshur, por duke mos treguar dhëmbët.

Ndërsa, testi i tretë kishte pjesëmarrës që përputheshin me fotot ku vetëm gjysma e poshtme e fytyrës së personit ishte e dukshme. Rezultatet e të tre studimeve treguan se buzëqeshjet me gojë hapur u krahasuan me normat më të larta.

"Hulumtimi ynë sugjeron që zëvendësimi i shprehjes neutrale që zakonisht përdorim kur marrim fotografitë e identifikimit me një buzëqeshje të hapur mund të bëjë fytyrën tonë që të përputhet me një vendim më të lehtë", tha dr. Mileva.

"Sapo ekziston një mospërputhje në shprehjen emocionale. Studiuesit sugjerojnë se fotografitë e qeshura mund të ndihmonin agjentët e emigracionit në kontrollin e pasaportave dhe potencialisht të zvogëlonin mashtrimet e identitetit. Duhet të siguroheni që kjo është një nga vendimet e miratuara nga Departamenti i Shtetit.

"Ju duhet të keni një shprehje neutrale të fytyrës ose një buzëqeshje natyrore, me të dy sytë hapur", thuhet në faqen e internetit të Departamentit të Shtetit.



Gjashtë sekretet e kafesë

Kafeja është pija e preferuar e të rriturve dhe jo vetëm, e në këtë artikull Syri zbulon gjashtë mite dhe të vërteta për efektet e saj

Disa njerëz thjesht nuk mund ta fillojnë ditën e tyre pa konsumuar një filxhan kafe, ndërsa të tjerët preferojnë ta shmangin atë nga frika e ndërlikimeve në shëndetin e tyre. Ka shumë mite që rrotullohen rreth kafesë, por këtu i zbulojmë disa:

- **Shkakton pagjumësi:** E vërtetë! Kafeina është një nxitës që është i pranishëm në kafe, çokolatë dhe disa analgjecikë.

- **Është digestive:** E vërtetë. Kjo pije stimulon sekrecionin e stomakut, kështu që duke pirë një filxhan kafe pas çdo vakti rrit nivelet e acidit në stomak dhe përmirëson tretjen.

- **Rrezik për shëndetin:** False. Kur kafeina konsumohet në përmasa të kërkuara, ajo nuk krijon asnjë rrezik për shëndetin. Sipas raportit Natursan, rekomandohet të pini një maksimum prej tri gota në ditë

- **Dëmton fëmijët:** False. Nuk ka dëshmi për ta konfirmuar atë. Dhe nuk ka asnjë lidhje mes konsumit të kafesë në fëmijëri dhe adoleshencë, si dhe në moshë madhore.

- **Përmirëson performancën seksuale:** False. Substanca nuk ka efekt të drejtpërdrejtë në procesin e epshit dhe erotizimit apo performancës seksuale.

- **Redukton vdekjen e parakohshme:** E vërtetë. Pirja e tre kafeve në ditë redukton vdekshmërinë e parakohshme në 18%, sipas hulumtimit të kryer nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Mos konsumimi i mishit do të ulte shanset për sëmundjet koronare të zemrës, diabetin dhe disa lloje kanceri. Kjo do të ulte faturën e botës në ilaçe me rreth 2-3% të Prodhimit Global Bruto. Mishit do të duhet të zëvendësohet me ushqyes të tjerë, sidomos tek dy miliardë njerëzit e nënshqyer të botës

Nëse bota do të hiqte dorë nga mishi...



Nëse çdokush do të bëhej vegetarian deri në vitin 2015, do të kishte rreth 7 milionë vdekje më pak në vit. Këto vdekje do të uleshin me 8 milionë nëse ata do të bëheshin veganë. Lëshimet e gazrave në atmosferë të lidhura me ushqimin

do të ulje me 60%, sipas një studimi të programit "E ardhmja e ushqimit" të universitetit Oxford Martin. Kjo si pasojë se njerëzit do të eliminonin mishin e kuq nga dietat e tyre, dhe rrjedhimisht edhe gjedhët që prodhojnë metan.

Por nga kjo mund të vuanin fermerët në vendet në zhvillim. Në zonat e thata ku vetëm kafshët mund të rriten, si në zonën e Sahelit në Afrikë, pranë shkretëtirës së Saharës, ku grupet nomade që mbajnë bagëti do të duhet të rrinin përgjith-

monë, duke humbur edhe identitetin e tyre kulturor. Kullotat e mëparshme do të shndërroheshin në habitate natyrore dhe pyje, të cilat do ndihmonin në luftën kundër ngrohjes globale dhe do të sillnin një biodiversitet të humbur. Kafshë të mëdha si bufalot dhe grabitqarët si ujçërit do të populloheshin, pasi në të shkuarën vriteshin ose largoheshin me qëllim që të ruhej bagëtia. Të gjithë ata që merreshin me industrinë e gjësë së gjallë do të duhej të gjente një punë tjetër në agrikulturë, rripullëzim, etj. Por me mungesën e alternativave të shumta të karrierës, papunësia do të rritej jashtëzakonisht shumë, sidomos në komunitetet rurale. Bagëtisë si delet do të ishin jetësore për të mos patur

një impakt negativ në biodiversitet, ndaj fermerët do të duhej t'i mbanin këto kafshë për arsye mjedisore. Edhe traditat fetare do të ndryshoheshin shumë. Do të humbisnin kështu gjeli i detit për Krishtlindje, mishi i therrur për Bajram, e shumë festa të tjera.

Mos konsumimi i mishit do të ulte shanset për sëmundjet koronare të zemrës, diabetin dhe disa lloje kanceri. Kjo do të ulte faturën e botës në ilaçe me rreth 2-3% të Prodhimit Global Bruto. Mishit do të duhet të zëvendësohet me ushqyes të tjerë, sidomos tek dy miliardë njerëzit e nënshqyer të botës. Produktet shtazore kanë më shumë vlera ushqyese për kalori, se sa gruri apo orizi.

ALBIN KURTI: SHQIPËRIA DHE KOSOVA, TË NDËRTOJNË BE-në BRENDË VETES

Shqipëria dhe Kosova duhet të ndërtojnë BE-në brenda vetes, pasi nuk janë të integruara ende me njëra-tjetrën. Kështu mendon lideri i Vetëvendosjes Albin Kurti në këtë intervistë.

Sipas Albin Kurtit, Shqipëria dhe Kosova kanë shumë për të bërë për rimëkëmbjen e ekonomive respektive ndërsa shton se bashkimi kombëtar dhe integrimi evropian nuk e pengojnë njëri-tjetrin.

Duke folur për shqiptarët e Maqedonisë, Albin Kurti tha se ata vendosën të heshtin për emrin e ri pasi zgjidhën integrimin sa më shpejt në NATO dhe BE. Ndërsa situatën në Kosovë Albin Kurti e përshkroi kaotike me një qeveri të pakicës, zgjidhja e së cilës do të ishin zgjedhjet e parakohshme.

Kurti tha se është e djathta në BE që është investuar tek ideja se vendet e Ballkanit fillimisht duhet të reformohen e më pas të integrohen.

Fatkeqësisht të djathtë në BE mundohen të minimizojnë të djathtët e tjerë. Si pasojë e trysnisë së djathtë në BE, mbizotëron bindja se duhet të reformohemi e më pas të integrohemi.



Ne jemi në kontinentin e Evropës, por është thëllim i bashkëpunimit ekzistues. Ka një keqkuptim për BE-në, e përjetojnë shumë si vlerë dhe pak si interes. Me strukturën që kemi ne, jemi shumë pak në tregun evropian. Duhet të rimëkëmbim vendet tona, e duke e ndërtuar BE-në brenda vetes sonë, sepse është ky interesi ynë.

I pyetur për aktualitetin politik në Kosovë dhe qeverisjen Haradinaj, Kurti e cilësoi një "qeveri pakice që ka më shumë parti sesa deputetë".

Kemi një qeveri të pakicës e cila nuk arrin të kalojë proj që sponsori-

zon. Qeveria ka shumë pak, deputetë, më shumë ka parti se deputetë. Është një dëshmi se në Kosovë mungon dominimi nominal. Është me rëndësi të kemi zgjedhje të lira, t'i hapim rrugë zhvillimit dhe progresit. I pyetur për tarifën e vendosur në Rrugën e Kombit, Kurti tha se tarifa duhet të hiqet për të afruar shqiptarët sa më pranë njëri-tjetrit.

Besoj që nuk duhet të ketë një taksë të tillë rrugore. Nafta është shumë e shtrenjtë në Shqipëri, paguhet taksa e qarkullimit, është mëse e mjaftueshme. Kemi vetëm këtë bregdet, duam të na hiqet dhe kufiri në Morinë, jo të na dyfishohet.

Ekonomia, integrimi, dhe bashkimi kombëtar, këto kanë qenë disa nga çështjet për të cilat ka folur lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, në një intervistë për Report Tv.



Rama takohet me Trump

Kryeministri i vendit, Edi Rama, është takuar me presidentin amerikan, Donald Trump gjatë samitit që po mbahet këtë të enjte mes vendeve të NATO-s.

Ka qenë vetë kryeministri që ka shpërndarë një foto mes tij dhe Trump në rrjetin social Facebook.

Deri më tani nuk ka asnjë detaj se çfarë mund të jetë biseduar mes tyre./abcnews.ala



Sipas mediave serbe NATO do t'i kërkojë falje Serbisë?

Mediat serbe vazhdojnë të thurin teori konspirative në lidhje me atë që NATO-ja mund të bëjë në raport me Serbinë. Gazetarët serbë kanë pyetur rreth uraniumit të varfëruar që u përdor nga NATO në bombardimet mbi Serbinë më 1999. Kurse përgjigja e Gottemoeller ishte: "OKB dhe NATO kanë bërë studime e kanë arritur në përfundim se uraniumi i varfëruar ka pak ndikime në shëndetin e njerëzve". Gottemoeller tha se e di se në Serbi ka shqetësime në raport me NATO-n, por se nuk e kanë larguar ndonjëherë Serbinë përgjithmonë, shkruan B92.

ÇFARË NUKU PA NGA SAMITI I NATO-S



Edi Rama heq atletet

Samiti i NATO-s në Bruksel ka mbledhur liderët më të fuqishëm në botë. Sytë natyrisht që ishin tek Donald Trump dhe Angela Merkel, që patën edhe një përplasje deklarata. Në Samit merrte pjesë dhe kryeministri Edi Rama, që këtë radhë ka hequr atletet dhe është shfaqur me këpucë. (TemA)

Deputetët votojnë pro projektligjit për Dhomën e Posaçme

Kuvendi i Kosovës ka nisur seancën me votimin e projektligjeve nga seancat e kaluara, ku ndër të tjera është votuar edhe projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSME) 2014-2020", është tërhequr për shkak të mungesës së korumit. Ndërsa, projektligji për Eficiencë të energjisë dhe projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete, kanë kaluar në Kuvend.



Oda Amerikane kundërshton importimin e veturave të vjetra

Pas vënies në diskutim të iniciativës për ndryshim të Ligjit për Automjete nga ana e Kuvendit të Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane u ka dërguar të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës një shkresë duke shprehur shqetësimet e saj lidhur me iniciativën për heqjen e ndalesës për importin e veturave më të vjetra se dhjetë vite. "Oda Amerikane dëshiron ta përsërisë qëndrimin e saj se ndryshimi i Ligjit nr. 05/L-132 do të rriste nivelet e ndotjes të cilat edhe ashtu rapor-

tohen më të larta dhe në periudha të caktuara të vitit, si ajo e dimrit të kaluar, krijojnë shqetësime për qytetarët. Implikimet e tilla në mjedisin rrethues do të kishin implikime edhe në aspektin e sigurisë dhe shëndetit për qytetarët e Kosovës. Ndërsa, një veprim i tillë do të ishte edhe në kundërshtim me iniciativat brenda Bashkimit Evropian për reduktimin e emetimeve të gazrave që lirohen nga automjetet e lehta dhe të rënda", njoftohet në komunikatën e Odës Amerikane.

Për më tepër, Oda Ekonomike Amerikane shpreh edhe një herë besimin e saj të fuqishëm se jefikasiteti i automjeteve të vjetra do të minimizonte çfarëdo përfitimi afatshkurtër që do të mund të gjenohet nga lejimi i importit të veturave të tilla. Prandaj, u kërkon deputetëve të Kuvendit të Republikës që të mos e jetësojnë iniciativën e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal./RTV 21



Mediat lokale informojnë se tek qytetarët ekziston pakënaqësi e madhe nga masat e sigurisë, ku shumë prej tyre kanë lëshuar fluturimet apo takimet e dakorduara. Sipas shërbimeve të sigurisë, një operacion i këtillë përgatitor nuk është parë ndonjëherë në Belgjikë në 20 vitet e fundit dhe në të janë inkuadruar gjitha forcat e vendit.

Liderët e NATO-s do ta kthejnë vëmendjen tek konflikti në Afganistan në ditën e dytë të samitit të dominuar deri më tani nga kërkesat e presidentit Donald Trump.

Pas disa mosmarrëveshjeve duke fajësuar njëri tjetrin, aleatët besojnë që do të gjejnë zgjidhje me një ton pajtues, para se Trump të udhëtojë në Britani të Madhe.

Trump në rrjetin e tij social "Twitter" ka filluar kritikën e tij të ashpër duke thënë se "SHBA po shpenzon miliarda dollarë për t'a subvencionuar Evropën, duke humbur në tregun ndërkombëtar".

Të mërkurën, Trump i kërkoi aleatëve të NATO-s të angazhoheshin për 4 për qind të GDP në shpenzime ushtarake. Ai po ashtu veçoi Gjermaninë në kritikën e lidhjeve me shpenzimet e saj ushtarake. Liderët e NATO-s shpresojnë për tone më pajtuese të enjten, para

SAMITI I NATO-S

NGA KRITIKAT E TRUMPIT TË KONFLIKTI NË AFGANISTANIN



se Trump të largohet nga Britania e Madhe. Por, në një postim në "Twitter", natën vonë, nga Brukseli, presidenti amerikan përsëriti kritikën e tij. "Miliarda dollarë shtesë po shpenzohen nga vendet e NATO-s që nga vizita ime vitin e kaluar, me kërkesën time, por kjo nuk mjafton – shkruante ai. Më herët, Trump akuzoi Gjermaninë se ishte peng i Moskës për shkak të varësisë nga gazi rus, duke pretenduar se ajo totalisht kontrollohej nga Moska.

Shifrat e BE sugjerojnë se Rusia

është përgjegjëse për 50 deri në 75 për qind të importeve të gazit të Gjermanisë por gazi zë më pak se 20 për qind të energjisë që konsumohet në Gjermani. Ditën e dytë të samitit, presidenti afgan, Ashraf Ghani, do të jetë i pranishëm dhe sekretari i përgjithshëm i aleancës shpreson që blloku të bjerë dakord për të financuar forcat afgane të sigurisë deri në 2024.

Kryeministria britanike Theresa May, ka konfirmuar se Britania e Madhe do të dërgojë edhe 440 trupa

pa shtesë të shërbejnë në rolejo luftarake në Afganistan. SHBA po ashtu do të dërgojë 3 mijë trupa shtesë për të mbështetur forcat afgane në shtator 2017, duke e çuar numrin total në 15 mijë. Tema tjetra diskutimi në samit do të jenë edhe lidhjet e aleancës me Gjeorgjinë dhe Ukrainën, vende që kërkojnë t'i bashkohen NATO-s, por sidoqoftë, nuk pritet progres mbi ambicien e tyre. Kjo për shkak se Rusia është angazhuar në ndërhyrje territoriale në të dyja shtetet dhe rregullat e

NATO-s ndalojnë vendet me konflikte territoriale, t'i bashkohen asaj.

Brukseli është plotësisht i gatshëm për ditën e dytë të takimit të kreut të NATO-s, për sigurinë e të cilëve kujdesen 2.400 policë dhe 1.000 ushtarë, të rreshtuar në çdo 100 metra përgjatë rrugës nga qendra deri te Aeroporti.

Mediat lokale informojnë se tek qytetarët ekziston pakënaqësi e madhe nga masat e sigurisë, ku shumë prej tyre kanë lëshuar fluturimet apo takimet e dakorduara.

Autoritetet nuk kanë publikuar paraprakisht se si do të jenë implikimet kundrejt jetës së zakonshme në qytet për shkak të masave të sigurisë. Në qytetin ka 55 delegacione dhe mbi 30 shefa të shteteve apo qeverive. Sipas shërbimeve të sigurisë, një operacion i këtillë përgatitor nuk është parë ndonjëherë në Belgjikë në 20 vitet e fundit dhe në të janë inkuadruar gjitha forcat e vendit. Qytetarët janë të pakënaqur pasi politikanët duhet t'u shërbejnë atyre në vend të kontribuojnë në shqetësimin e jetëve të tyre. Ata theksojnë se edhe krahas pagesës së tatimeve dhe përmbushjes së detyrave të tyre qytetare, nuk mund të lëvizin në qytetin e tyre.

PUTINI E QUAN FITORE TAKIMIN ME TRUMPIN

Pritjet janë të mëdha janë Rusi sepse Putini, me më shumë se 18 vjet përvojë globale, do të jetë në avantazh përballë Trumpit, i cili nuk ka pasur përvojë politike përpara se të zgjidhej president, në vitin 2016. Trump dhe Putin janë takuar më herët në ngjarje të tjera dhe kanë folur në telefon së paku tetë herë. Trump ka thënë se nuk mund të vlerësojë nëse homologu i tij rus është mik apo armik



tensionuara të Rusisë me SHBA-në dhe aleatët e saj, Kremli, për kohë të gjatë, ka bërë përpjekje të aranzhojë takimin, duke vënë bast se Putin dhe Trump do të shkojnë shumë mirë së bashku.

Edhe pse askush nuk pret përparim të madh, samiti në Moskë shihet si njohje e statusit të Rusisë si fuqi e madhe dhe vetëdijesim i SHBA-së se interesat rusë duhet të merren parasysh.

"Fakti se takimi Putin-Trump do të ndodhë, tregon vetëm një gjë: pavarësisht gjithë histerisë, Shtetet

e Bashkuara nuk mund të izolojnë ose injorojnë Rusinë", tha Alexei Pushkov, deputet rus nga partia në pushtet "Rusia e Bashkuar", transmeton Reuters.

"I është dashur kohë e gjatë Uashingtonit ta kuptojë këtë, por më në fund e kuptoi", tha ai.

Zemërimi i Perëndimit për aneksimin e gadishullit ukrainas të Krimesë nga Rusia, si dhe për ndërhyrjen e Moskës në luftërat në lindje të Ukrainës dhe në Siri, nuk është zbehur. Akuzat e tjera, që hidhen poshtë nga Moska, përf-

shijnë ndërhyrjen e saj në zgjedhjet në SHBA dhe në politikën në Evropë, furnizimin me armë për rrëzimin e një aeroplani të pasagjerëve në vitin 2014 në Ukrainë, si dhe përpjekjet e saj për të vrarë një ish-spiun rus në Britani me agjent nervor.

Kritikët e Kremliut, si në Rusi, ashtu edhe jashtë saj, e shohin vendimin e Trumpit për t'u takuar me Putinin si dhënie e legjitimitetit ndërkombëtar Putin, një gjë që, sipas tyre, ai nuk e meriton, pasi politika ruse në arenën ndërkombëtare nuk ka ndryshuar.

Por, në Rusi, ku sistemi politik është i fiksuar me hierarkinë dhe shfaqjen e forcës, Putini "tashmë ka fituar", tha Andrey Kortunov, analist me seli në Moskë, raporton Reuters.

"Samiti i mundëson Putinin të thotë se Rusia nuk është e izoluar, se Rusia është fuqi e madhe dhe se, në njëfarë mase, mund të ketë status të barabartë me Shtetet e Bashkuara, së paku në fushën e sigurisë", tha Kortunov.

Pritjet janë të mëdha janë Rusi sepse Putini, me më shumë se 18

vjet përvojë globale, do të jetë në avantazh përballë Trumpit, i cili nuk ka pasur përvojë politike përpara se të zgjidhej president, në vitin 2016. Trump dhe Putin janë takuar më herët në ngjarje të tjera dhe kanë folur në telefon së paku tetë herë.

Vitaly Tretyakov, një autor politik rus, e përshkroi Trumpin si "fillstar në politikën botërore", të cilit Putini mund t'i shpjegojë të menduarit rus dhe faktin përse Rusia "ka pasur të drejtë" ta aneksojë Krimesën.

Sergei Mironov, një tjetër ligjvënës nga partia "Rusia e Bashkuar", tha se Putin padyshim se do të jetë më lart se Trump.

"Vladimir Putin do t'i japë mësim të vërteta politikanit të papërvojë, Donald Trump", tha Mironov.

Samiti Trump-Putin do të mbahet në Helsinki më 16 korrik. Trump ka thënë se nuk mund të vlerësojë nëse homologu i tij rus është mik apo armik, porse takimi me të do të jetë pjesa më e lehtë e udhëtimit në Evropë, që përfshin pjesëmarrjen e tij në samitin e NATO-s dhe vizitën në Britani. /REL/

NJË DOKUMENT JUGOSLLAV QË HEDHË DRITË MBI NGJARJET E VITIT 1968

POZITA E SHQIPTARËVE NË RS TË MAQEDONISË



Nga Qerim LITA

Zvarritja e vendimeve të marra në mbledhjen e Katërt të KQ të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë e cila u mbajt më 1 korrik 1966 në Brione, ku ndër të tjerave thuhej: "kombësia shqiptare, ngjashëm si kombet e kombësitë tjera në RSFJ-ë, do ti fitoj të gjitha të drejtat e veta nacionale, politike, arsimore, kulturore ekonomike etj", krijoi një pakënaqësi tek popullsia shqiptare në RS të Maqedonisë. Në këto rrethana, në sipërfaqe doli inteligjenca shqiptare, e cila shtroi një sërë kërkesash të cilat kishin për qëllim përmirësimin e statusit të shqiptarëve në RSFJ-ë, që shqiptarët, ngjashëm si kombet tjera në Jugosllavi, të kenë një qendër të vetme politike e kulturore; popullsia të quhet shqiptare (albanci) e jo si deri atëherë "shiptari"; shqiptarëve t'ju mundësohet përdorimi i lirë i simboleve kombëtare; krijimi i institucioneve të larta arsimore e kulturore etj.. Tërë kjo, për ta, ishte mase e domosdoshme, për arsye se, "realizimi i barazisë në Maqedoni ishte demagogji", se "ekziston numri i madh i të burgosurve, se UDB deri në Plenumin IV i ndiqte vetëm shqiptarët, se gjuha shqipe ishte e nënçmuar, se punësimi i shqiptarëve nëpër institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore ishte shumë i vogël...etj". Ndër intelektualët shqiptar të cilët asaj kohe patën guxim të zërin kundër padrejtësive, duhet veçuar shkrimtarin tonë të mirënjohur Memedali Hoxhën, pastaj Imer Imerin, Rezak Halimin, Sali Ramadanin - Kërçovën etj.

Duhet theksuar se kërkesat e shtrura nga inteligjenca shqiptare, udhëheqja komuniste maqedonase në krye me Kërste Cërvenkovskin i vlerësonte si "nacionaliste", përkatësisht "armiçësore", të cilat për qëllim kanë "cenimin e integritetit territorial të RS të Maqedonisë" dhe krijimin e "një republike të vetme për shqiptarët në RSFJ". Si rrjedhojë e një qasje të tillë të kreut të LKM-së ndaj problemit shqiptar, gjatë vitit 1967 në trevat shqiptare të kësaj republike u zbuluan një numër i madh i parullave me përmbajtje antishqiptare. Një parullë e tillë u zbulua në dhjetor të vitit 1967 në qendër të Gostivarit, përmbajtja e së cilës ishte me sa vijon:

"Disa shokë tanë si Imer Imeri, Rezak Halimi etj, të cilët mbajnë funksione me përgjegjësi janë luftëtar për Shqipërinë e Madhe dhe se ata kërkojnë bashkëngjitjen e një pjese të Maqedonisë me Shqipërinë. Shkruarit e parullës në fjalë - thuhej më tej në informatë 'patriotët e mëdhenj' të Maqedonisë, kërcë-

nohen se janë të gatshëm të luftojnë kundër këtyre udhëheqësve". Për të parë më për së afërmi se si trajtohej problemi shqiptar në këtë republikë nga ana e udhëheqjes partiake jugosllave, në vazhdim po e botojmë dokumentin me titull "Problemet rreth marrëdhënieve ndërnacionale në Maqedoni" i cili është botuar më 2 shkurt 1968 në Buletin e KQ të LKJ-së në Beograd. Originali i dokumentit gjendet në Arkivin e Jugosllavisë, fondi 507 (KQ i LKJ-së) në Beograd.

nohen se janë të gatshëm të luftojnë kundër këtyre udhëheqësve".

Për të parë më për së afërmi se si trajtohej problemi shqiptar në këtë republikë nga ana e udhëheqjes partiake jugosllave, në vazhdim po e botojmë dokumentin me titull "Problemet rreth marrëdhënieve ndërnacionale në Maqedoni" i cili është botuar më 2 shkurt 1968 në Buletin e KQ të LKJ-së në Beograd. Originali i dokumentit gjendet në Arkivin e Jugosllavisë, fondi 507 (KQ i LKJ-së) në Beograd.

PROBLEMET RRETH MARRËDHËNIEVE NDËRNACIONALE NË MAQEDONI

Buletini i KQ të LK të Maqedonisë, përçollti disa informata /nga KRR të LKM-së Kisella Vodë - Shkup; KRR të LKM-së Strugë; KRR LKM-së Gostivar/ për disa dukuri nacionaliste të cilat janë zhvilluar në kohë të fundit në këtë Republikë. Disa prej tyre po i nxjerrim në pah, si dhe për mënyrën e zgjidhjes së të drejtave të kombësive.

Studentët e vitit të I e të II të grupit albanologjik si dhe studentët të grupit turk pranë Akademisë Pedagogjike kah mbarimi i vitit të kaluar, përmes një letre i janë drejtuar Këshillit të arsimtarëve dhe drejtorit të Akademisë, në të cilën ankohen për stërngarkimin e programit për shkak të mësimit të lëndëve ndihmëse dhe kërkojnë të largohet mësimi i lëndës së letërsisë jugosllave. Kërkesën e njëjtë e kanë dërguar edhe arsimtarët e gjuhës shqipe dhe turke të kësaj Akademie. Në mbledhjen me arsimtarët e gjuhës shqipe dhe turke, në të cilën erdhi deri te një konflikt bukur i madh /"këtu është Jugosllavi e jo Shqipëri/, arsimtarët e gjuhës shqipe dhe turke propozimin e modifikuan me atë që të ngelet lënda e letërsisë jugosllave - me fondin e zvogëluar të orëve.

Vitin e kaluar, /19 dhjetor/ gjatë pritjes me rastin e ndarjes së shpërbllimit "Koço Racin" në grupin e punëtorëve të njohur kulturor të Maqedonisë, Memedali Hoxha (në dokument qëndron Memed Alihoxha - Q. L) filloi ti ofendoj të pranishmit, pranë së cilës shtroi edhe çështje të karakterit nacional, madje në disa raste ofendoi kombin maqedonas dhe e mohoi ekzistimin e tij. Ai ka thënë se nuk ekziston kombi maqedonas; se nuk ka Akademi të Shkencave dhe Arteve Maqedonase porse ekziston Akademia e Shkencave dhe Arteve në Maqedoni; se ka shumë pak shkolla shqipe (në dokument thuhet

"shiptarski" - Q. L.), ndërsa në reagimin e njërit prej pjesëmarrësve se në Shqipëri nuk ka asnjë shkollë maqedone edhe pse ka popullsi maqedonase, ai është përgjigjur se "maqedonasit nuk janë për shkollë porse për të pastruar rrugët e Tiranës".


Për shkak marrjes së aksionit për ngritjen e flamurit shqiptar nga ana e pjesëtarëve të grupit irredentist në rrethin e Strugës ose të personave, të cilët ata i kanë angazhuar, si dhe me qëllim të pengimit të aktivitetit armiçësor të grupit, është ngritur procedurë penale kundër 7 personave. Vihet në dukje se në grupin ilegal janë përfshi edhe persona nga Ohri, Struga, Resnja dhe Manastiri.

Në informatën e shkruar të cilën një grup i qytetarëve të Kërçovës ia kanë dorëzuar KQ të LK të Maqedonisë, me rastin e hapjes së paraleleve shqipe (në origjinal "shiptarske") në gjimnazin e qytetit, theksohet se "kundër kësaj iniciative kanë qenë kryetari i Kuvendit Komunal, sekretari i Komitetit, kryetari i LSPPM-së, kryeshafi i shërbimit shoqëror e të tjerë". Në informatë kritikohet edhe mënyra e deritanishme e zgjidhjes së çështjes kadrovike, sjellja e disa profesorëve ndaj nxënësve shqiptarë si dhe situata e përgjithshme në gjimnaz. Gjithashtu insistohet se "në bashkësitë territoriale ku jetojnë më shumë kombësi, ngritja e kuadrut duhet shikuar mbi bazën e më shumë kombësive" - për çka kësaj çështje nuk i është dhënë rëndësi në Kërçovë.

Në fjalën hyrëse në mbledhjen e zgjeruar të KRR të LK Gostivar /mbajtur më 4 dhjetor 1967/, me rastin e shqyrtimit të dukurive është përmendur edhe reagimi i disa anëtarëve të LK-së në lidhje përdorimin publik të gjuhës së kombësive /mbishkrimet, sipërmarrjet/. Është theksuar rasti i parullës së vendosur në një librarri në të cilën ofendohen disa shokë /pjesëtarë të kombësisë shqiptare/, pastaj reagimi i SPB-së lidhur me rastin për gjoja këndimin e himnit shqiptar në restorantin "Central".

Gjithashtu përmendet edhe rasti i shkollës tetëvjeçare në shatin Vërtok ku, për shkak vendimit që në paralelet me mësime në gjuhën maqedonase gjuha shqipe të jetë lëndë obligative, erdhi deri te ndërprerja tetëditor të mësimit. Rasti i ngjashëm ka ndodhë edhe në fshatin Sencë etj.

(Nga buletini i KQLKJ-së. Beograd, 2 shkurt 1968)



EDICIONI I 58-të I FESTIVALIT "VERA E OHRIT"

GËRSHETIM I MUZIKËS, TEATRIT DHE ARTIT NË PËRGJITHËSI

Ohri prej mbrëmje (e enjte) e deri më 20 gusht do t'i jetojë 40 ditët e veta me emocione që i sjellë Festivali "Vera e Ohrit". Mbi 800 artistë nga 27 vende nga e mbarë bota për të 58-tën herë me radhë gjatë një muaji e gjysmë në vijim do të interpretojnë, aktojnë, krijojnë në skenat e festivalit në Ohër

Gjatë mbrëmjeve të festivalit, "Vera e Ohrit" do të sjellë gërsheetim të përsosur të muzikës, teatrit dhe artit në përgjithësi. Do të interpretojnë emra të njohur nga bota e muzikës, por edhe produksionet më të mira teatrore me projekte të shkëlqyeshme dramatike. Janë papaparë edhe tre ekspozita, figurative, ekspozitë e fotografive dhe stollive bashkëkohore.

Hapja solemne e manifestimit tonë më të rëndësishëm muzikor-skenik në mënyrë tradicionale filon në skenën e madhe të Teatrit antik. Kësaj radhe në teatrin antik të rezervuar për yjet e mëdha operistike, sopranja Elena Moshuc dhe tenori Kalin Bratesku, në dirigjimin e Nikollae Moldoveanu dhe të shoqëruar nga Filarmonia e Maqedonisë.

Festivalin e shpalli të hapur mbështetësi i manifestimit, presidenti Gjorge Ivanov, ndërsa fjalim para publikut në hapje kishte edhe ministri i Kulturës i Republikës së Maqedonisë, Asaf Ademi. Porosinë artistike këtë vit e transmetoi aktori i njohur Nikolla Ristanovski.

Artistët Moshuc, Bratesku dhe Moldoveanu të cilët tashmë



ndodhen këtu, paralajmëruan angazhim maksimal, përvojë të paharruar dhe koncert për t'u mbajtur mendn sonte në Teatrin antik.

Kryetari i i Komunës së Ohrit, Jovan Stojanoski, në konferencë për shtyp me rastin e hapjes së "Verës së Ohrit" paralajmëroi se komuna edhe më tutje do ta japë mbështetjen e parzërvë për festivalin, si një brend i madh kulturor i Maqedonisë dhe Evropës.

Si përjetime të posaçme të edicionit të 58-të të festivalit priten koncertet e pianistit Nikollaj Lluganski, çelistit Aleksandar Knjazev, violinistit Sergej Krillov, më pas pianistit Aleksandar Maxhar, virtuozit në harmonikë Antonio Serano, sekstetit a-kapella "D'Kuina Siks" nga Britania e madhe, si dhe disa koncerte që do të realizohen në bashkëpu-

nim me ambasadat në Maqedoni. Mbrëmja tradicionale polake e festivalet do të sjellë koncert të ansambllit të barokut "Vrocllav", në kuadër të Mbrëmjes franceze do të interpretojnë pianisti me famë botërore Mishel Burdonkle dhe djali i tij Nikollas, ndërsa në bashkëpunim me Ambasadën e Spanjës në Shkup do të interpretojë sopranja Eugenia Boiks dhe pianistja Ana Ferer.

Programi i dramës fillon një ditë pas hapjes solemne, ndërsa do të ofrojë kreacione nga shtëpi vendore teatrore, si dhe pjesëmarrje të teatrove nga Serbia, Kroacia dhe Sllovenia.

Sipas traditës, në kuadër të "Verës së Ohrit" do të interpretojnë edhe një numër i madh i artistëve nga Filarmonia e Maqedonisë, Ope-

ra dhe Baleti i Maqedonisë dhe Rina muzikore e Maqedonisë.

Sipas u.d. drejtoreshë e "Verës së Ohrit", Suzana Vrencovska, të gjitha skenat dhe hapësirat ku këtë vit do të mbahen ngjarjet muzikore-skenike të festivalit janë adaptuar për artistët, si dhe për vizitorët të cilët çdo vit janë gjithnjë e më të shumtë, ndërkaq siç paralajmëroi, nga viti i ardhshëm është planifikuar ndërtimi i sallës montuese të shfaqjeve e cila do të mund të vendoset çdokund, me çka do të mund të mbahen ngjarje në çdo vend adekuat në qytet.

Festivali "Vera e Ohrit" mbahet me mbështetje financiare nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë, ndërkaq i ndihmuar nga Komuna e Ohrit, si dhe nga sponsorë të shumtë.



Filmi "Nëntor i ftohtë" premierë botërore në San Sebastian

Premiera botërore për filmin artistik të regjisorit Ismet Sijarinës "Nëntor i ftohtë" do të mbahet në edicionin e 66-të të Festivalit ndërkombëtar të filmit të San Sebastianit.

Ky është filmi i parë nga Kosova në këtë festival ndërkombëtar, tejet i rëndësishëm dhe i kategorisë A, i cili do të jetë në konkurrencë zyrtar në Seksionin e regjisorëve të rinj.

"Ky është një zhvillim i madh për kinematografinë e Kosovës dhe pasqyron një trend të sukseseve në rritje për industrinë e filmit në Kosovë", thotë drejtori i QKKS-së, Arben Zharku.

Filmi përcjell Fadilin, i cili punon si arkivist në një ndërmarrje shtetërore, në Kosovën e fillimiteve '90, dhe duhet të zgjedhë mes dy opsione të gabuara. Në këtë mënyrë ai, jashtë vullnetit dhe dëshirës së tij, "gëlltit" turpin, ballafaqohet me imazhin e keq dhe duron presionin nga të gjitha palët.

"Secili njeri, pa marrë parasysh rolin dhe ndikimin e tij në shoqëri, ka një rrëfim për ta thënë.

Ka shumë rrëfime të tilla që mbesin të pathëna, ngase konsiderohen po aq të parëndësishme sa edhe përjetuesit e tyre. "Nëntor i ftohtë" është një nga këto rrëfime që nuk do duhej të thuhej. Ky film sjell një histori familjare...

MODUS Events, organizator i 'BeerFest Kosova' njofton se festivali i parë dhe më i madh i birrës në Kosovë, do ta mbajë edicionin e 8 të tij prej 25 deri më 29 korrik, në qendër të kryeqytetit (Prishtinë) tek parkingu prapa Pallatit të Rinisë.

Edicioni i 8 i 'Beerfest Kosova', vjen më atraktiv se më parë



me për vizitorët e beerfest Kosova nga të cilat edhe 4 birra vendore dhe të gjitha këto do të jenë në dispozicion për adhuruesit e birrës me cmime promovuese.

Nuk do të mungojnë edhe ushqimi e pijet jo-alkoholike si dhe lojrat argëtuese e shpërblyese' shpjeguan organizatorët nga MODUS Events.

Organizatorët njoftuan se edhe sivjet, sikurse në edicionin e kaluar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe kordinim të plotë me Komunën e Prishtinës janë kordinuar që për të gjithë qytetarët të ju ofrohet një festë shumë mirë e organizuar dhe gjithë përfshirëse.

Si ngjarja që mbledh numrin

"Në 8 vjetorin e BeerFest Kosova, me lokacion tek Parkingu prapa Pallatit të Rinisë, ku e gjithë hapësira do të transformohet me krijimin e shtandeve impozante dhe vizualisht të mrekullueshme të kompanive prezente. Skenë gjigande të kompletuar me zërim të përmasave të festivaleve të

medha, të mbushur me efekte speciale vizuale dhe program artistik shumë të larmishëm dhe të pasur për të gjitha shijet. E veçanta e këtij edicioni është edhe programi muzikorë ku do të performojnë artistet me fame botërore dhe vendore

si: Duft Punk Tribute, Full Vacuum, Nr, The Bloody Alboz, Gentia Ismaili e shumë të tjerë", tha Leart Zeqa, drejtori ekzekutiv i Modus Events.

Do të jenë prezente birrat më të njohura dhe më të dëshiruesh-

më të madh të vizitoreve në Kosovë, Beerfest Kosova tashmë është festivali më i njohur argëtues dhe promocional dhe rrjedhimisht edhe ngjarja më atraktive në vend.

Si festival i birrës, kjo ngjarje është e hapur vetëm për personat e moshës mbi 18 vjet, dhe për të hyrë në hapsirën e festivalit do të nevojitet letërnjoftimi.

Beerfest Kosova edhe këtë herë, ashtu si çdo vit tjetër, do të ofrojë hapësirë për argëtim gjithë përfshirës për të gjithë ata të cilët do të jenë të pranishëm.

MODUS fton të gjithë dashamirët e Birrës të vizitojnë dhe të jenë pjesë e FESTËS MË MADHE NË KRYEQYTET". / Zëri

ME SHITJEN E FANELLAVE DHE ABONIMEVE VJETORE

RONALDO DO T'I SJELLË 100 MILIONË EURO NË VIT FITIME JUVES

Këtë fakt e tregoi marka "Juventus" e kuotuar në bursë, që edhe pse mbi emrin e skuadrës qarkulloi emri i lojtarit portugez, aksionet e saj pësuan një rritje të çmimit (nga data 29 qershor deri më 4 korrik), duke kaluar nga 0.65 euro për njësi në 0.73 euro, një rritje prej 12 për qind në një hark kohor prej pesë ditësh



Kristiano Ronaldo është një lojtar i Juventusit zyrtarisht dhe për këdo që mendon se ky operacion i kryer nga bardhezinjtë është një çmenduri, në të vërtetë, për ekspertët e marketingut dhe financiarët, është një operacion, nga i cili "Zonja e Vjetër" do të përfitojë jo vetëm në aspektin sportiv, por edhe atë financiar. Këtë fakt e tregoi marka "Juventus" e kuotuar në bursë, që edhe pse mbi emrin e

skuadrës qarkulloi emri i lojtarit portugez, aksionet e saj pësuan një rritje të çmimit (nga data 29 qershor deri më 4 korrik), duke kaluar nga 0.65 euro për njësi në 0.73 euro, një rritje prej 12 për qind në një hark kohor prej pesë ditësh. E gjithë kjo bëri që vetë Juventus si markë të rriste vlerën e tij me të paktën 200 milionë euro "virtuale" në tregjet botërore, por imagjioni se çfarë mund të ndodhë ta-

shmë që Ronaldo është zyrtarisht një futbollist i klubit më të titulluar në Itali.

ABONIMET – Me sa duket, Juventus kishte marrë garanci me kohë nga Ronaldo, sepse fakti që drejtuesit rritën abonimet me 30 për qind për sezonin e ardhshëm (tribunat anësore kaluan nga 495 në 595 euro në sezon) dhe fillimisht shtynë tifozërinë në një ankesë publike, tashmë gjithçka do të gël-

litet, sepse për të parë Ronaldon në aksion, abonentët e "Zonjës së Vjetër" do t'i sjellin të paktën 10 milionë euro më shumë në sezon klubit (vjet nga biletat në kampionat u fituan 25.7 milionë euro), por imagjioni se sa do të jetë shifra e biletave për në Çampion, ku vetëm për fazën e grupeve pritet një fitim që të kalojë nga 14 milionë euro për 3 ndeshje, në të paktën 22 milionë euro në total (të

paktën 8 mln më shumë për 3 ndeshjet e grupeve).

BLUZA dhe të tjerat – Kuadrado ia ka dorëzuar 7-ën e famshme Kristianos dhe në Kinë bluzat e para kanë dalë në shitje, edhe pse jo origjinale. Gjithsesi, nga sot në të gjitha dyqanet e licencuara do të dalin në shitje fanellat e tij dhe, sipas llogaritjeve të para, fitimet vetëm në vitin e parë pritet të kapin 50 milionë euro. Përveç kësaj, nga Torino raportojnë se edhe imazhi i portugezit do të ndikojë edhe te sponsorët, nga të cilët priten të paktën 30 milionë euro hyrje të shpejta, por mos harrojmë edhe rrjetet sociale. Vetë Ronaldo numëron 330 milionë ndjekës personalë, shumë prej të cilëve tashmë do të nisin të ndjekin edhe Juven. Ndaj edhe këtu, vetëm nga klikimet priten disa miliona. Në fund, llogaritë e bëra nga specialistët nënvizojnë se për Juven do të ketë 100-150 milionë euro më shumë fitime në vit.

Publicitet

Në bazë të nenit 19 pika 11, nenit 19-a dhe nenit 23 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, dhe 64/18) dhe Vendimit për publikim të konkursit publik për zgjedhje të Drejtorit të NP "Studençica" Kërçovë, Këshilli drejtues i NP "Studençica" Kërçovë, publikon

KONKURS PUBLIK
për zgjedhje të Drejtorit të NP "Studençica" Kërçovë

1. Publikohet konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit të NP "Studençica" Kërçovë.
Për drejtor mund të zgjidhet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:
– Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
– Të arrijë së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit,
– Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
– Ka minimum pesë vjet përvojë pune, dhe
– Të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të njohura aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, të caktuara me nenin 23 paragrafi 4 alineja 5 e Ligjit për ndërmarrjet publike, edhe atë: TOEFL iBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2.

VËREJTJE: Nëse kandidati nuk përmbushë kushtin nga pika 1 alineja 5 e shpalljes për njohje të gjuhës angleze ka obligim ligjor të njëjtin ta përmbushë në afat prej 1 viti nga dita e emërimit të tij në të kundërtën i ndërpritet mandati. (Neni 13 i Ligjit për emërim dhe plotësim të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 64/18).

2. Kandidatët duhet të parashtojnë dëshmitë për përmbushje të kushteve edhe atë:
– Biografi të shkurtër (CV),
– Certifikatë të shtetësisë,
– Diplomë ose certifikatë për mbarim të përgatitjes profesionale,
– Vërtetim se në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
– Vërtetim për përvojë të punës dhe
– Dëshmi se posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje të gjuhës angleze të caktuara me nenin 23 paragrafi 4 alineja 5 e Ligjit për ndërmarrjet publike.
Dëshmitë parashtohen në original ose kopje të vërtetuara në noter.

3. Drejtori zgjidhet për mandat prej 4 (katër) vjet.
4. Konkursi publik zgjatë së paku 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor.
5. Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të realizohet më së voni në afat prej 23 ditëve nga dita e përfundimit të konkursit publik.
6. Kandidatët dokumentacionin e kompletuar në zarf të vullosur duhet ta dorëzojnë në adresën: NP "Studençica" Kërçovë, Bul. "Osloboduvanje" nr. 60A/1-1 Kërçovë me shenjë "për konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit", drejtpërdrejtë në arkiv çdo ditë pune prej ora 8.30 deri në ora 16.30 ose të rekomanduar përmes postës.
7. Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtohen brenda afatit të caktuar dhe fletëparaqitjet të cilat nuk përmbajnë dokumentet e kërkuara do të konsiderohen si të vonuara gjegjësisht të pakompletuara dhe të njëjtat nuk do të merren parasysh.

Kryetari i Këshillit drejtues
Oliver Nestoroski

Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopihtes

Tel: ++389 2 27 85 100
Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. 2, Nr 2, f. Sopihte, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk

Nr. i procedurës: 15993
Nr. 28-43/18 nga 09.07.2018

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik për Dokumentacionin planor lokal urbanistik me qëllim A4 – Vendosje të përkohshme, në PK 2222/1 dhe PK 2222/2 KK Sopihte-jvq, Komuna e Sopihtes.

Bëhet prezantim dhe anketë publike për Dokumentacionin planor lokal urbanistik me qëllim A4 – Vendosje të përkohshme, në PK 2222/1 dhe PK 2222/2 KK Sopihte-jvq, Komuna e Sopihtes.

Përshirja planore dokument për Dokumentacionin planor lokal urbanistik me qëllim A4 – Vendosje të përkohshme, në PK 2222/1 dhe PK 2222/2 KK Sopihte-jvq, Komuna e Sopihtes është me sipërfaqe prej 0.55 m2.

5. Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopihtes më datë 18.07.2018 në ora 10.00.

6. Anketa publike do të zgjasë deri më 25.07.2018, në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për Planifikim hapësor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

7. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejtje, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.

8. Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës Sopihte
Stefçe Trpkovski

KOMUNA E KARPOSHIT
KRYETARI I KOMUNËS

MKA
CERTIFIKAT
MKC EN ISO 9001:2009

Në bazë të nenit 35 ndërsa në lidhje me nenin 51, paragrafi 10 i Ligjit për planifikim hapësor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Karposhit, në vijim sjellë

LAJMËRIM

Për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për ndryshim të kufijve mes PN 11.35 dhe PN 11.36, KK Bardovcë, Komuna e Karposhit, Shkup, me klasë themelore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banimi, prej SPU Bardovcë, përpunim të blloqeve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 17 dhe blloku 18 do të mbahet më datë 18.07.2018 në ora 13.00, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Anketa publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për ndryshim të kufijve mes PN 11.35 dhe PN 11.36, KK Bardovcë, Komuna e Karposhit, Shkup, me klasë themelore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banimi, prej SPU Bardovcë, përpunim të blloqeve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 17 dhe blloku 18 do të mbahet më datë 18.07.2018 në ora 13.00, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Prezantimi publik për Projektin arkitektonik-urbanistik për ndryshim të kufijve mes PN 11.35 dhe PN 11.36, KK Bardovcë, Komuna e Karposhit, Shkup, me klasë themelore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banimi, prej SPU Bardovcë, përpunim të blloqeve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 17 dhe blloku 18 do të mbahet më datë 18.07.2018 në ora 13.00, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Përshirja projektuese është kufizuar në sipërfaqen e parcelave të përmendura ndërtimore, të formuara nga PK 533/14, PK 533/15 dhe pjesë të PK 533/2, PK 533/12, PK 533/13 KK Bardovcë.

Sipërfaqja e përfshirjes së hapësirës për të cilën ka të bëjë ky Projekt arkitektonik-urbanistik është P= 1166.27 m2.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike do të gjenden në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në sistemin E-urbanizam

Lajmërimi për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike, shfaqja grafike për Projektin arkitektonik-urbanistik për ndryshim të kufijve mes PN 11.35 dhe PN 11.36, KK Bardovcë, Komuna e Karposhit, Shkup, me klasë themelore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banimi, prej SPU Bardovcë, përpunim të blloqeve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 17 dhe blloku 18 dhe informatat me të detajuara për të njëjtat do të publikohen në UEB faqen e Komunës së Karposhit - www.karpos.gov.mk.

Në afatin e caktuar, subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mund të parashtojnë vërejtjet në listat anketuese në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në formë elektronike përmes sistemit informativ E-urbanizam, në pajtim me nenin 35 paragrafi 5 të Ligjit për planifikim hapësor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

KRYETARI I KOMUNËS
I KOMUNËS SË KARPOSHIT
Stefan Bogoev

KOMUNA E KARPOSHIT
KRYETARI I KOMUNËS

MKA
CERTIFIKAT
MKC EN ISO 9001:2009

Në bazë të nenit 35 ndërsa në lidhje me nenin 51, paragrafi 10 i Ligjit për planifikim hapësor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Karposhit, në vijim sjellë

LAJMËRIM

Për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelave ndërtimore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banimi në PK 492/1 të KK Bardovcë, Komuna e Karposhit – Shkup.

Anketa publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelave ndërtimore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banimi në PK 492/1 të KK Bardovcë, Komuna e Karposhit – Shkup do të mbahet prej më 16.07.2018 deri më 20.07.2018, çdo ditë pune prej ora 07.30 deri më 15.30, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Prezantimi publik për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelave ndërtimore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banimi në PK 492/1 të KK Bardovcë, Komuna e Karposhit – Shkup do të mbahet më datë 18.07.2018 në ora 13.00, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Kufiri i përfshirjes projektuese përshtatet me parcelën e caktuar ndërtimore PN 11.22 dhe paraqet pjesë të PK 492/1 KK Bardovcë.

Sipërfaqja e përfshirjes së hapësirës për të cilën ka të bëjë ky Projekt arkitektonik-urbanistik është P= 3086 m2.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike do të gjenden në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në sistemin E-urbanizam

Lajmërimi për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike, shfaqja grafike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelave ndërtimore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banimi në PK 492/1 të KK Bardovcë, Komuna e Karposhit – Shkup dhe informatat me të detajuara për të njëjtat do të publikohen në UEB faqen e Komunës së Karposhit - www.karpos.gov.mk.

Në afatin e caktuar, subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mund të parashtojnë vërejtjet në listat anketuese në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në formë elektronike përmes sistemit informativ E-urbanizam, në pajtim me nenin 35 paragrafi 5 të Ligjit për planifikim hapësor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

KRYETARI I KOMUNËS
I KOMUNËS SË KARPOSHIT
Stefan Bogoev

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

RONALDO, NEJMAR DHE 10 TRANSFERIMET E KOMBINUARA TË TË GJITHA KOHËRAVE

Barriera prej 100 milionë euro është thyer disa herë, që kur ai u transferua në kryeqytetin spanjoll, si nga Geret Bejll, Pol Pogba, Neymar, Ousmane Dembele, Kilian Mbappe dhe Kutinjo. Por, transferimi i fundit i Ronaldos e kthen atë në krye të kësaj liste, kur bëhet fjalë për tarifat e grumbulluara të transferimit, me vetëm 222 milionë euro të Nejmarit, që kaloi te PSZH, duke e mbajtur atë larg nga numri një



transferimi i fundit i Ronaldos e kthen atë në krye të kësaj liste, kur bëhet fjalë për tarifat e grumbulluara të transferimit, me vetëm 222 milionë euro të Nejmarit, që kaloi te PSZH, duke e mbajtur atë larg nga numri një.

Duke pasur parasysh normën, në të cilën tarifat e transferimit duket të jenë në rritje, Ronaldo mund të mos jetë në gjendje ta mbajë vendin e tij për një kohë të gjatë. Megalëvizja e Mbappe te PSZH e vë atë vetëm 41 milionë euro pas ikonës së Portugalisë, por ylli i ri i Francës tashmë është nënvizuar si një pasardhës i mundshëm i KR7 në Madrid. Pas realizimit të ëndrrës së tij, kalimit te Barcelona për një tarifë, që mund të rritet në 160 milionë euro, Philippe Koutinjo nuk është shumë prapa Mbappe.

Në "Camp Nou" ka kaluar edhe Dembele, për të cilin Barcelona ka paguar në fillim 105 milionë euro, shumë që mund të rritet deri në 145 milionë euro. Angel Di Maria, futbollisti argjentinas, i cili në hapësirën e një viti fluturoi në Mançester Junajted për

74.6 milionë euro, para se të kalonte te PSZH për 61.6 milionë euro, ishte në krye të listës vitin e kaluar, por "spërkatjet" e fundit në të gjithë Evropën e kanë rrëzuar disa vende. Duke pasur parasysh moshën e tij (36 vjeç) dhe, ndoshta më e rëndësishmja, agjenti i tij Mino Raiola, nuk është e habitshme që sulmuesi suedez, Zlatan Ibrahimoviç, është në tryezë, kryesisht falë transferimit prej 69.5 milionë eurosh, por të pasuksesshëm, nga Interi te Barcelona, në vitin 2009. Diku tjetër, kalimi i sulmuesit argjentinas Gonzalo Higuain për 90 milionë euro, nga Napoli te Juventus, në vitin 2016, është kryesisht përgjegjës për vendin e fundit në "top 10". Nëse ai e lë Juventusin pas ardhjes së Ronaldos, siç parashikojnë shumë në Itali, mund ta shtyjë atë në krye të "top 10". Në vitin 2017, Nikolas Anelka, Huan Sebastian Veron dhe Hernan Krespo, tre futbollistë që kanë gëzuar karriera peripatetike, ishin ende në renditje të larta në këtë drejtim, por tani ekziston një pamje krejtësisht e freskët dhe moderne në listë.

JO VETËM KRISTIANO RONALDON

Juve vijon të bëjë pazar te Reali

Ndoshta është një indice që nuk e bën të mjaftueshme të raportohet për lajm. Por diçka e tillë, nëse iu komunikohet tifozëve, e për më tepër vetëm 24 orë pasi u zyrtarizua "transferimi i shekullit", sigurisht që mund t'i bëjë të kalojnë në dëlir e pse jo të ëndërrojnë. Mbrojtësi brazilian i Realit, Marcelo, është bërë ndjekës i profilit zyrtar të Juventusit në "Instagram". Me shumë gjasë, ky është një tregues që ka të bëjë me shumë për afrimitetin e tij me Cristiano Ronaldo, me të cilin është shok jo vetëm për një çështje të thjeshtë: gjuha dhe komunikimi më i lehtë me portugezin. Por, tifozët bardhezinj të Juventusit po ëndërrojnë dhe këtë e kanë shfaqur hapur edhe në rrjetet sociale, ku "hashtag"-u #Marcelo po kthehet në trend edhe në "Twitter". Mes të tjerash, kjo çështje është e lidhur edhe me nevojat për të mbuluar krahun e majtë të mbrojtjes



së Juventusit. Gjithçka mbetet e lidhur me fatin e një tjetër brazilian, si Aleks Sandro, i cili gjithmonë ka qenë mes dilemës mes

nxjerrjes së tij në merkato dhe mundësisë për ta mbajtur, përmes rinovimit të kontratës.

LAJME SHKURT

United në bisedime të avancuara për Bejll

Mançester Junajtedi është në negociata të avancuara me Real Madridin për të marrë Geret Bejll, sipas lajmeve të fundit. "The Manchester Evening Nees" ka bërë të ditur se uellsiani është objektivi kryesor i "Djajve të Kuq". Sipas shkrimit, edhe në rast se dy klubet bien dakord "Bejll do të ketë fjalën e fundit". "Bejll do të flasë me trajnerin e Realit, Julen Lopetegui dhe më pas do të vendosë", tha menaxheri i sulmuesit Xhonatan Barnett. 28-vjeçari ka një kontratë deri në 2022-in me kampionët e Evropës në fuqi, por duhet të luftojë për një vend si titullar me Asension dhe Iscon.

Atalanta merr sulmuesin kolumbian


Atalanta bën goditjen e madhe në merkato. Skuadra ku luan edhe portieri i kombëtares shqiptare Etrit Berisha ka marrë nga Sampdoria shërbimet e sulmuesit kolumbian Duvan Zapata i cili është transferuar në Bergamo në huazim për dy vite me opsion blerjeje nga ana e klubit zikaltër. Shifrat e transferimit nuk bëhen të ditura ndërsa Sampdoria ka falënderuar Zapatën për kontributin e dhënë në sezonin teksa në 32 paraqitje me klubin dorian arriti të realizonte 11 gola.

Uest Hemi merr edhe Jarmolenkon

Uest Hemi po bën një merkato të shkëlqyer këtë verë dhe këtë e tregojnë goditjet nga drejtuesit e klubit. Pas Rajan Frederiks, Issa Diop, Fabianskit dhe Xhek Uillsher, ekipi i drejtuar nga Manuel Pellegrini kompletoi edhe blerjen e Andrij Jarmolenko nga Borussia Dortmundi për 20 milionë euro. Sulmuesi 28-vjeçar mbylli kështu pas 12 muajsh aventurën në Bundesligë me tre gola në 18 ndeshje teksa firmosi për katër sezone me "Hammers".

Lenglet te Barcelona për 35 mln euro

Barcelona do të ketë përforsimin e dëshiruar në mbrojtje dhe është pikërisht Klement Lenglet të cilin e kishte piktuar prej kohësh. Bisedimet me drejtuesit e Seviljës ishin të vështira pasi këta të fundit dëshironin të rinovonin me lojtarin për t'ia rritur klauzolën por Barcelona tashmë ka bërë efektive pagimin e klauzolës aktuale prej 35 milionë euro. Lenglet ia ka bërë të qartë drejtuesve që dëshiron ekipin katalanas ndaj dhe refuzoi rinovimin dhe tashmë kalimi i tij te Barcelona mund të quhet i kryer.



Kolumbia merr hak për kopertinën e tabloidit anglez

Gjatë raundit 1/8 final të Botërorit, tabloidi i njohur anglez, "The Sun", publikoi një faqe të parë polemike për ndeshjen midis Anglisë dhe Kolumbisë. Behet fjalë për një lojë fatkeqe me sulmuesin yll të anglezëve dhe kokainës. Titulli i madh ishte: "Go Kane!". Që fonetiki-sht dukej shumë si "kokainë" (cocaína në spanjisht). "The Sun" e bëri këtë, pasi shpjegoi se "Tre Luanët" po përballëshin me një vend, që i kishte dhënë botës Shakirën dhe një kafe të mirë, ndër të tjera. Në Kolumbi u zemëruan nga kjo faqe e parë dhe, megjithëse u eliminuan, ishin të gjithë duke prituri që e njëjta gjë të ndodhte me Gareth Southgate e të tijtë. Dhe të mërkurën Anglia u eliminua në gjysmëfinale të Kupës së Botës nga Kroacia, kështu që shpejt kolumbianët nisën të hakmerren. "Memmes" që qarkullojnë në "Twitter" flasin qartë për këtë.

PERISHIÇ FLET PAS FITORES NDAJ ANGLISË DHE KUNDËRSHTARIN NË FINALE

"Franca na ndaloi në gjysmëfinale, në vitin 1998. Ne do të kemi një motivim shtesë për shkak të kësaj, me siguri, por kjo është një histori krejtësisht e ndryshme. Ata janë favoritët, por ne do të bëjmë çmos për t'i befasuar", pohon Perishiç

Një mrekulli sportive e kohëve moderne; një komb me katër milionë njerëz do të luajë në finalen e Kupës së Botës. Kështu mund të përmblihet kryevepra e Kroacisë në këtë Botëror. Tashmë duket se pak rëndësi ka nëse kupa shkon apo jo në shtetin ballkanas, pasi për popullin kroat është realizuar një ëndërr e madhe. Kur arbitri turk vërshëlleu tri herë në minutën e 120+4, futbollistët në fushë dhe në stol u lëshuan si dallgë drejt tribunës ku qëndronin tifozët e tyre, të veshur të gjithë me ngjyrat kuq e bardhë. Një nga heronjtë e ndeshjes ishte Ivan Perishiç, sulmuesi që shënoi golin e barazimit në minutën e 64-t, duke i rikthyer bashkëkombësit e tij në ëndërrën më të bukur të tyre.

"Kjo është diçka e papërshtueshme", – tha Perishiç pas ndeshjes. – Është një nder i madh për të gjithë lojtarët dhe mbështetësit. Nuk mendoj se jemi ende të vetëdijshëm për këtë që kemi bërë! Askush nuk besonte para Kupës së Botës që ne do të arrinim deri këtu, por besuam dhe ja ku jemi", shtoi më tej Perishiç. Më tej, futbollisti i Interit është shprehur se ky brez lojtarësh ka një veçori, që edhe pse vuajti në fushën e lojës në tri ndeshjet e fundit, arriti të fitonte dhe

RAST IDEAL PËR T'I KTHYER "BORXHIN" FRANCËS



Luka Modrić

Gazetarët dhe ekspertët anglezë në televizion po bisedonin para kësaj ndeshjeje rreth nesh, duke na quajtur të lodhur, se jemi të vdekur në këmbë. Këto fjalë nga ata na dhanë edhe më shumë zell për t'iu provuar se po gabonin. Ata duhet të jenë më të përlulur dhe të respektueshëm. Kur ju luani një gjysmëfinale, është e pamundur të jeni të lodhur. Kemi treguar se, përveç kundër Argjentinës, kjo ishte loja jonë më e mirë në këtë Botëror. Është një ëndërr e vërtetë për ne, për të gjithë Kroacinë. Askush nuk na dha një shans para kësaj Kupe Bote, por me cilësinë tonë, dëshirën, bashkësinë dhe shpirtin e luftës, që kemi treguar gjatë gjithë turneut, ne jemi në finale. Unë mendoj se e meritojmë të jemi atje

tashmë mendon për finalen. "Përsëri ishte dramatike, nuk mund të ndodhte ndryshe. Tri ndeshjet e fundit kemi vuajtur shumë, por kemi arritur të dalim triumfues. Kjo flet shumë për shpirtin tonë si ekip. Kjo është një veçori e vërtetë e këtij brezi lojtarësh. Na ka mbetur dhe një ndeshje dhe kurrë më shumë se tani nuk kemi qenë të motivuar", vazhdon Perishiç për mediat, pas sfidës me Anglinë. Më pas, Perishiç ka thënë se Kroacia nuk luajti mirë, ndërsa në pjesën e dytë niveli i lojës u rrit shumë. "Pje-

sa e parë nuk ishte e mirë për ne, luftuam shumë pak dhe Anglia meritonte të shënonte, por në gjysmën e dytë e tutje ishim shumë më mirë dhe treguam vlerat tona të vërteta". Kujtojmë, para nisjes së këtij Kampionati Botëror, trajneri i Kroacisë, Zlatko Daliç, identifikoi një problem madhor për ekipin e tij, obsesionin me Francën në vitin 1998. Tani, një brez i ri, i frymëzuar nga kapiteni Luka Modrić, ka krijuar historinë e vet. "Franca na ndaloi në gjysmëfinale, në vitin 1998. Ne do të kemi një motivim

shtesë për shkak të kësaj, me siguri, por kjo është një histori krejtësisht e ndryshme. Ata janë favoritët, por ne do të bëjmë çmos për t'i befasuar", – ka përfunduar Ivan Perishiç.

Kemi nxjerrë mësim nga finalja e "Euro 2016"

Samuel Umtiti, mbrojtësi i Barcelonës, ishte heroi i madh i gjysmëfinale franceze, kur ai shënoi golin e fitores kundër Belgjikës. Dy ditë pas atij dueli, ai foli për mediat në një konferencë shtypi në Moskë. Në fillim ai foli për rivalin e tyre në finale, Kroacinë. "Ne e dinim se në këtë turne do të luanim kundër lojtarëve më të mirë në botë. Do ta përgatisim me kujdes finalen dhe do të përpiqemi t'i ndalojmë lojtarët të tillë si Modrić, Manxhukij apo Rakitić. Ne nuk duhet të lejojmë që Rakitić dhe Modrić të luajnë si duan ata, përndryshe do të jetë shumë e lehtë për ta", pohon Umtiti. Mbrojtësi pranoi se kroatët janë të lodhur, por tha se kjo është një finale dhe luhet vetëm një ndeshje. "Kur arrin në fund të kampionatit, ka lodhje, sidomos me tri ndeshje radhazi, që kanë dashur kohën shtesë. Fizikisht, kroatët duhet të jenë të lodhur, por kjo është një finale, është një ndeshje. Ata kanë mundësinë të jenë kampionë të botës, kështu që do të konkurrojnë si në të gjitha ndeshjet e tyre", pohon Umtiti, i cili u ndal të flet për mësimet e nxjerra nga finalja e "Euro



2016". "Ne kemi marrë mësim të vlefshme nga kjo finale e humbur. E dimë se kemi disa pika për t'i përmirësuar, por unë mendoj se ne jemi në rrugën e duhur. Jemi rritur dhe kemi treguar se mund të jemi shumë të fortë", shtoi më tej mbrojtësi i Barcelonës. Në fund Umtiti foli për mënyrën se si e festoi golin kundër Belgjikës. "Diçka kam dashur të them, Pogba dhe Criezmann duan të më shohin mua", përfundoi Umtiti.

Do kujtohemi gjithmonë për Botërorin që kemi bërë

Trajneri i Anglisë, Geret Sautgejt, shprehu krenarinë dhe zhgënjim, pasi skuadra e tij u rrëzua nga Kampionati Botëror në gjysmëfinale, të mërkurën. "Tre Luanët" u mundën 2-1 nga Kroacia në kohën shtesë, pasi Mario Manxhukij shënoi një gol për t'i thyer zemrat angleze. "Unë mendoj se Kroacia luajti mirë në pjesën e dytë, ndërsa ne e kemi humbur kontrollin e topit dhe filluam të bëhemi pak më gjatë, – tha trajneri i Anglisë për "BBC Radio 5 Live". "Kur jeni kaq shpejt në avantazh, në një lojë kaq të madhe, dhe shumë nga lojtarët e tu nuk kishin luajtur më parë në këtë stacion, askush nuk e di se si do të reagoni. E dinim se skuadra që sollëm në këtë Botëror ishte më e papërvajë në konkurrim dhe e vetmja mënyrë që ne do ta rritim këtë është duke luajtur në sa më shumë lojëra të turneut. Unë jam jashtëzakonisht krenar nga mënyra se si luajtën lojtarët dhe mund të lumturohem nga reagimi i mbështetësve, ata ndjehen njësoj. Është e vështirë të thuash ndonjë gjë, që do t'i bënte ata të ndiheshin më mirë. Kjo para-



qitje e Anglisë mund të jetë një eksperiencë e paharrueshme për vendin tonë. Ne, si ekip, kemi bërë përparim të pabesueshëm dhe ndoshta kemi arritur në një stad, që në fillim të turneut do ta kishim konsideruar sukses. Por, me të vërtetë besuam se mund të shkolin në finale", deklaroi Sautgejt.



DASHI 21. mars - 20. prill

Do të përfshihen në një debat mjaft të ndezur, i cili rrezikon që të kthehet agresiv. Mundohuni që të mos keni reagime të tepruara dhe sidomos të mos merrni shumë vendime drastike, sidomos nëse po mundoheni të rikuperoni një raport.



DEMI 21. prill - 21. maj

Gjatë kësaj të enjteje do të keni mundësi që të merrni pjesë në evente të rëndësishme, lidhur me realizimin e një projekti të ri. Janë ditë të cilat ju shohin mjaft të qetë dhe kjo gjë do të ndikojë pozitivisht në bashkëpunimin me kolegët.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Parashikohet një ditë e suksesshme, e cila do ju shohë të përfshirë në çështje vendimtare për karrierën tuaj profesionale. Nëse në familje kohëve të fundit ka patur momente tensioni, duhet të jeni ju të parët që të kërkonin një balafaqim. Kompromiset janë shumë të mundshme.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Mundohuni që ta kaloni këtë të enjte në mënyrë aktive dhe dinamike, për shkak se intuata juaj do ju mundësojë që të bëni progres të ndjeshëm në vendin e punës. Kjo e enjte është mjaft e favorshme për të zhvilluar takime.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Është mjaft e rëndësishme që të rishikoni raportet tuaja ndërpersonale dhe të largoni të gjithë personat që nuk ju përshtaten. Në dashuri parashikohen fitore të mëdha, njëlloj si dhe në punë. Ndaj mundohuni që të jeni sa më pozitiv.



VIJRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Parashikohet një fundjavë relaksuese dhe e rëndësishme për të marrë disa përgjigje në dashuri. Nisni me planifikimin e aktiviteteve verore. Bashkëpunimet janë mjaft të favorshme.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do të keni mundësi të takoni një person nga e kaluara juaj, gjë që do të ngjallë tek ju ndjesi mjaft pozitive. Duhet të jeni më të hapur për dialog dhe mos u druani që të përballeni, pasi mund të zbuloni anë të karakterit, të cilat i keni injoruar prej kohësh.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Mos jini dembel, për shkak se tashmë keni të gjitha kapacitetet për të marrë rezultate të mëdha në vendin e punës. Edhe në dashuri, duhet të jeni sa më karizmatik dhe tërheqës, ndaj mos i shmangni daljet. Veç duhet të bëni kujdes sa i takon shëndetin fizik.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Kjo është një periudhë tranzicioni e rëndësishme, e cila do ju lejojë që të kompletoni të gjithë pritshmëritë tuaja dhe prioritetet, sidomos sa i takon dashurisë dhe ndjenjave.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Një takim romantik do ju lejojë që të kaloni më shumë kohë cilësore me partnerin/en. Nga ana tjetër ditët e fundit ju kanë gjetur mjaft të ngarkuar, kështu që do të ndjeni nevojën për të marrë më shumë kohë për veten dhe çështjet e ndjenjave. Parashikohen avantazhe të mira edhe nga pikëpamja ekonomike.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Sugjerohet që gjatë kësaj të enjteje të mos hyni në konflikt me familjen ose partnerin/en. Do të jeni mjaft të ndjeshëm dhe emocional për të përballuar një konflikt pa lënduar dikë. Këshillohet që të përqendrohni vetëm në prioritetet tuaja.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Mundohuni që të merrni kohë, për të organizuar sa më mirë prioritetet tuaja. Në këtë mënyrë do të shmangni të papriturat apo shqetësimet në punë, lidhur me një projekt të ri. Dashuria ju bën mjaft euforik.

PERANDORI EGJIPTAS	F	AKTIVITETI MUZIKOR BAMIRËS I VITIT 1985 (FOTO)	JO E AFËRT	E	KLUB ITALIAN					
HEROI I TROJES										
VEPËR LETRARE										
BANOR I VIETËR ANES TISËS										
OC			GERMANIUMI							
DITËN PAS SODIT			CARI BULLGAR							
MONEDHAT RUIKE										
L										QYTETI ANGLEZ, KU U MBAJT KONCERTI MË 13.07.1985
Mensur Mamuti	TULIUMI									
	PASTRIM, KULLIM									
RUMANIA										
			BILARDISTI KUBANEZ, ALFREDO DE OPERË E VERDIT							
KALLI SHPEJTË I MITOLOGJISË GREKE										
QYTETI AMERIKAN, KU U MBAJT KONCERTI MË 13.07.1985										
QYTEZË NË SLOVENI										
MOHIMI HUAJ										
QYTET NË KOSOVË										
GJ										
VEGËL SHTRËNGUESE										
KOHA	TETOVA									
	BELGJIKA									
NJËRI NGA THEMELUESIT E KONCERTIT BAMIRËS (SHQ.)										

ZGJIDHET: F, E, AKILI, ROMAN, ANART, OC, GE, NESËR, LIRAT, TM, L, R, ORO, ARION, FIJADELPIA, IG, MËKATAR, NO, IR, JUR, GJILAN, AVA, B, MENGENE, GA, TE, SAIMIR, BOB GELDOFI.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

		1			8					6						
3				9						5	7	9	2			
6	8	9			5	7	2	1		7	4	6	9			
8		2	7		1					6		9	7			
				2							9	2		3	8	6
				5		9	2		4		7	8		1		
9	7	8	4			5	3	2			1					
2				5							3			1	4	5
				5							8				3	

Shumë i lehtë: 451672893, 327198465, 689345721, 842731956, 596824317, 713569284, 978416532, 264953178, 135287649. Mesatar: 925834671, 863157942, 714692583, 642978135, 159243867, 378516294, 491365728, 236781459, 587429316.

Anatomia e trurit është e ndryshme ashtu si gjurmët e gishtërinjve

Anatomia e trurit të çdo njeriu është unike si gjurmët e gishtërinjve, thotë një hulumtim. Sipas një lajmi të Science Daily, në hulumtimin e bërë nga shkencëtarët e Universitetit Zyrih, thuhet se faktorët gjenetik dhe përvojat e jetës individuale, bënë që trutë e njerëzve të jenë të ndryshme njëri nga tjetri. Në hulumtimin e zhvilluar nën kryesimin e Lutz Jäncke, trutë e 191 pjesëmarrësve të moshuar dhe të shëndetshëm gjatë 2 viteve janë ekzaminuar 3 herë me MRI (Imazhimi i kokës me rezonancë magnetike). Shkencëtarët kanë vlerësuar mbi 450 veçori anatomike në mesin e të cilëve vëllimi i trurit, trashësia e korteksit dhe dendësia e lëndës me ngjyrë gri dhe të bardhë, kanë iden-



tifikuar karakteristika specifike të anatomisë së trurit tek secili pjesëmarrës. Jäncke tha se në hulumtimin e bërë

kanë arritur të konfirmojnë se struktura e trurit të njerëzve është shumë individuale.



I ha 50 specia të djegës për 68 sekonda, fiton monedhë ari 24 karatë

Një i ri kinez fitoi çmimin e parë në një konkurs në shijimin e specave djegës pasi hëngri 50 sish për vetëm 68 sekonda. Festivali mbahet për të dytin vit në Parkun e Funit Ningsiyang, në krahinën qendrore të Kinës Hunan, i famshëm për kuzhinën e tij me erëza. Fituesi Tang Shuhuihu mori një shpërblim – një monedhë ari prej 24 karatësh. Garuesit u ngarkuan për të ngrënë sa më shpejtë 50 paketime të specave sa më shpejt që të jetë e mundur, ndërsa gara u monitorua nga mjekët. Festivali i specave djegës do të vazhdojë deri në fund të gushtit.

Shoferi padit Trumpin: Më ka borxh 3300 orë jashtë orarit

Një njujorkez, i cili për më shumë se dy dekada ka punuar si shofer personal i Donald Trump, pretendon se presidenti aktual i SHBA, përkatësisht një nga kompanitë e tij, i ka borxh atij para të mëdha për mijëra orë të papaguara. Në një padi të paraqitur në Gjykatën e Lartë të Shtetit në Nju Jork, Noel Sintron pretendon se "Organizata Trump", emri kolektiv për më shumë se 500 kompani dhe organizata biznesi në pronësinë e presidentit amerikan, nuk pagoi gjithsej 3.300 orë jashtë orarit për gjashtë vjet. Noel Sintron pohon se për më shumë se një çerek shekulli ka punuar për Trump, dhe atë 50 deri 55 orë në javë. Ai mbeti pjesë e stafit më të afërt të Trump edhe kur shërbimet e si-

gurimit u kujdesën për të si shef të Shtëpisë së Bardhë. Në vitin 2010, paga e tij mujore u rrit nga 68.000 në 75.000 dollarë, por më pas iu hoqën kontributet për sigurim shëndetësor. Sintron thotë se në përputhje me rrethanat Trump ka kursyer 17.866 dollarë në vit. Shuma bazë e parave të papaguara është 178.000 dollarë, pasi Sintron ka punuar për 54 dollarë në orë, raporton Newshub. "Organizata Trump" nuk ka komentuar rastin. Përndryshe, kjo padi është vetëm një nga një numër i atyre që tashmë janë paraqitur në Gjykatën e Lartë të Shtetit të Nju Jorkut në Manhattan më parë, të cilat janë të drejtuara kundër Trump dhe kompanive të tij.



Samsung po punon për Galaxy Watch



Ka thashetheme që Samsung po punon për një linjë të re orësh që do të marrë emrin Galaxy. Mendohet se emri Galaxy është zgjedhur për faktin se është më i njohur nga linja e celularëve të markës. Zakonisht, Samsung i prezanton aksesoret e dorës në fund të gushtit dhe deri atëherë do të ketë shumë thashetheme të tjera mbi orën e re. Samsung sjell versionin e ngjyrës Sunrise Gold për smartphone Galaxy S9 dhe S9+, që doli në shkurt të këtij viti me ngjyrë të zezë mesnate, blu koralor dhe purpurtë jargavani. "Njerëzit duan të shprehin sti-

lin dhe personalitetin e tyre përmes teknologjisë dhe ngjyrës dhe këta smartfonë janë një pjesë e madhe e këtij personalizimi. Versionet e reja zgjerojnë ofrimin e ngjyrave të Galaxy S9 dhe S9+ me stile të gjalla që përqafojnë një ndjenjë moderne dhe klasike" tha Younghee Lee, Zëvendës Presidente Ekzekutive pranë Samsung Electronics. Versioni Sunrise Gold për Galaxy S9 dhe S9+ është pajisja e parë e Samsung me një shkëlqim të hollë saten, i cili e mbështjell smarfonin me një shkëlqim të qetë dhe të nderur.

1558 - Beteja e Garvelinit: Forcat spanjolle të udhëhequra nga Konti Lamoral i Egmontit mund forcat franceze të Marshallit Pol des Termes.

1573 - Haarlemi i dorëzohet armatës spanjolle pas 7 muaj rezistençë.

1645 - Aleksei Romanov trashëgon babanë e tij Mihail si Car të Rusisë.

1700 - Paqja ruso-turke.

1772 - Kapiteni Xhejms Kuk nisë udhëtimin e tij të dytë drejt deteve jugore.

1878 - Përfundon Kongresi një mujor i Berlinit.

1930 - Fillon Kampionati i parë Botëror në futboll në Uruguai.

1938 - Muzeu Kroller-Muller hapet në Holandë.

1941 - Lufta e II Botërore: Malazezët fillojnë kryengritjen popullore kundër forcave gjermane.

1945 - Bomba e parë atomike eksplodon në New Mexico.

1978 - Shqipëria ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Republikën Popullore të Kinës.



A e dini pse studentët gjatë diplomimit veshin këtë kostum? Studentët në ditën e diplomimit mbajnë një fjalim para një publiku me një veshje interesante që përbëhet nga një mantel i gjatë dhe një kapelë katërcepshe. Veshja e të diplomuarve ka një histori të gjerë. Kjo lloj veshjeje u realizua në shekullin XII-të, nxënësit dhe mësuesit zakonisht vishnin mantel dhe një kapele. Fillimisht kjo ishte një veshje klerikësh, duke qenë se shumë profesorë në atë kohë ishin priftërinj ose murgj. Oxford dhe Cambridge, ishin universitetet e para përdorën këto lloj veshjesh, pasi në atë kohë ishte e ndaluar që nxënësit/studentët të vishnin rroba të shkurtra.

PACIENTIA DHE PSIKOLOGU

Pacientja : Doktor, jam 15 vjeçe dhe shtatzënë, si t'u them prindërve?

Psikologu: Hap gojën e thuaj, përderisa di të hapësh këmbët, di të hapësh dhe gojën...



Nuk ka rëndësi si ndihesh sot, ngrihu, vishu dhe shfaqu...!

(Paulo Coelho)



KALENDARI HISTORIK 13 KORRIK



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS